



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më 08.04. 2022

V E N D I M

Nr.67 , datë 08.04. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën Nr.65 Regj, datë 13.04.2021, paraqitur nga ankuese D.K kundër Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njesisë Administrative Lis, me pretendimin se është diskriminuar në të drejtën për punësim, për shkak të “*bindjeve politike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur ankuesja ngre pretendimin se Bashkia Mat, në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë Administrative Lis, e kanë diskriminuar për shkak të bindjeve politike. Ankuesja deklaron se, në të shkuarën ka qenë pjesë e strukturave drejtuese të Partisë Demokratike, por në momentin që ka marrë statusin e nëpunësit civil dhe deri në momentin që është larguar nga puna, ka hequr dorë nga përfshirja në politikë.

Ankuesja shpjegon se, diskriminimi politik kundër saj ka filluar që në momentin e emërimit të administratorit të forcës tjetër politike, nëpërmjet presionit që ankuesja të jepte dorëheqjen. Sjelljet diskriminuese kanë filluar në datë 11.02.2020, kur administratori u rekomandua që të bënte vlerësimin 6 mujor të punës së saj, pavarësisht se ai vetë kishte filluar punë më datë 24.11.2019. Diskriminimi ka vazhduar duke i’u mohuar ditët e raportit. Ankuesja deklaron se shqetësimet e saj ia ka komunikuar Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Mat, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankuesja shprehet se, pas udhëzimeve që qeveria miratoi në mars 2020, që të gjithë qytetarët të karantinohen dhe shërbimet të kryehen online, ankuesja nën presionin e administratorit për largim nga puna, deklaron se është detyruar të shkojë çdo ditë në punë, duke rrezikuar në këtë mënyrë jetën e saj dhe të familjes. Ajo deklaron se është ndjerë e rrezikuar jo vetëm në ambientet e punës

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

që ishin jashtë të gjitha kriterëve të përcaktuara në protokollin kundër Covid 19, por edhe gjatë transportit të detyruar për shkak të largësisë prej 40 minutash me makinë. Për të gjitha këto shqetësime, ankuesja deklaroi se ka vënë në dijeni Kryetarin e Bashkisë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Në datën 26.06.2020, ankuesja deklaroi se, bashkia filloi procedurat për transferimin e saj në Njësinë Administrative Rukaj, me motivacionin e përmirësimit të performancës. Sipas saj, kjo njësi administrative ka transport të përditshëm vetëm në periudhën e shkollës dhe se transferimi u bë pikërisht gjatë periudhës së verës, në mënyrë që ajo të detyrohej të ecte përveç 60 minutave me makinë edhe 3 orë në këmbë vajtje-ardhje, me qëllimin e vetëm që të largohej nga puna. Pas përfundimit të periudhës 3 mujore të transferimit, ankuesja deklaroi se është rikthyer përsëri në Njësinë Administrative Lis, ku ka vazhduar të përballet me të njëjtin presion psikologjik në punë.

Ankuesja shpjegon se, gjatë kohës që familja e saj ishte e sëmurë me Covid, ajo njoftoi bashkinë duke vendosur në dispozicion gjithë dokumentacionin e nevojshëm, por bashkia filloi procedurat e largimit të saj nga puna. Gjatë procedurave për largimin e saj nga puna ankuesja deklaroi se administratori ka qenë i diagnostifikuar me Covid dhe për këtë arsye nuk mund të ishte prezent.

Sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri, të konstatojë sjelljen diskriminuese nga ana e Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njësisë Administrative Lis dhe detyrimin e tyre për të shfuqizuar vendimin nr.54, datë 05.02.2021, rikthimin e statusit të nëpunësit civil dhe rikthimin në punë, dëmshpërblim për prishjen e imazhit, dëmin psikologjik, ekzistencial dhe biologjik si dhe pagimin e raportit për ditët e mohuara, së bashku me lejen e zakonshme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga

Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.609/1 prot, datë 23.04.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Mat dhe Njësia Administrative Lis. Bashkia Mat ktheu përgjigje me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 11.05.2021³, duke parashtruar se:

Ankuesja ka përfshirë në ankesën e saj Bashkinë Mat dhe Njësinë Administrative Lis, me dashje ose nga mungesa e dijes, kur dihet qartësisht se, Njësia Administrative Lis nuk është institucion i pavarur dhe që vepron në mëvetësi, por është pjesë e strukturës së Bashkisë Mat, nga e cila varet. Njësia Administrative Lis nuk ka të drejtë të veprojë si subjekt i së drejtës më vete në marrëdhënie me të tretët, pasi nuk i është deleguar asnjë funksion i tillë, që ta konsideronte atë si entitet i shkëputur nga Bashkia Mat. Sipas Bashkisë Mat, nuk ka logjikë që Njësia Administrative Lis të përfshihet në ankesë si subjekt më vete.

Në lidhje me pretendimet dhe deklaratimet e ankueses se ka qenë anëtare e Partisë Demokratike (PD) në të shkuarën, por në momentin që ka marrë statusin e nëpunësit civil deri në momentin që është larguar nga puna, ka hequr dorë nga përfshirja në politikë, është një pretendim që është bërë “trend” i rasteve të tilla. Ankuesja nuk paraqet asnjë dokument që të provojë se ka qenë anëtare e PD Dega Mat, dokument anëtarësie, si dhe një dokument kur e ka dhënë dorëheqjen, pasi një vërtetim i lëshuar nga një drejtues dege i partisë, nuk provon bindshëm atë që ajo pretendon. Pretendimi është ngritur thjesht për vetëvlersim politik nga ana e saj. Kjo edhe për faktin e thjeshtë se, në funksionin politik që ajo pretendon se ushtron apo të ngjashëm me të, ka me dhjetra të tillë, madje që vijojnë të jenë edhe pjesë e administratës aktuale dhe madje që mund të jenë të njohur për bindjet e tyre politike, që po sipas ankueses janë të kundërta me ato të Kryetarit të Bashkisë Mat.

Në stafin aktual të bashkisë vijojnë të punojnë në pozicionet e mëparshme apo të ngjashme, pjesa më e madhe e stafit të mëparshëm të bashkisë, para ndryshimit të kryetarit të saj, pas zgjedhjeve të 30 qershorit 2019. Konkretisht janë të gjithë punonjësit e stafit të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pjesa më e madhe e stafit të Sektorit të Tatimeve dhe Taksave Vendore, përgjegjësi i Taksës së Pronës, sikundër edhe homologët e ankueses, specialistët e kadastrës bujqësore në Njësitë Administrative Rukaj, Ulëz, Koms, Baz dhe Derjan (të cilët janë emëruar nga drejtuesit e bashkisë para ardhjes në drejtim të kryetarit aktual të bashkisë), si dhe të gjithë punonjësit e stafit të Sektorit të Financës, të gjithë punonjësit e stafit të Infrastrukturës, të gjithë punonjësit e stafit të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shtresave në Nevojë, të gjithë punonjësit e Qendrës së Kulturës, Artit dhe Muzikës m duke përfshirë këtu edhe punonjësit e Bibliotekës së Qytetit, dhe kështu me radhë edhe në sektorët e tjerë. Një pjesë jo e vogël e tyre, janë pjesë e forcës politike të cilës sikundër pretendohet i përket edhe znj. K, që kanë patur dhe kanë funksione politike, por vazhdojnë të punojnë në pozicionet e mëparshme të punës apo të ngjashme, në Bashkinë Mat, por për arsye ligjore dhe etike bashkia shprehet se, nuk mund të përmendi emrat e tyre në shkresë, por që janë lehtësisht të verifikueshëm. Bashkia shprehet se, natyrshëm ka patur

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.609/2 prot., datë 17.05.2021.

edhe largime, që janë fokusuar në respektimin e kriterëve ligjore rast pas rasti, duke ju përshtatur strukturës së re të bashkisë dhe përmbushjes sa më të mirë të misionit të saj.

Bashkia Mat shprehet se, nuk ka asnjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur të pretenduar “bindja politike” dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë të ankueses, përderisa të gjithë kolegët e saj, të emëruar në punë nga ish-kryetari i Bashkisë Mat, vijojnë të jenë në marrëdhënie pune në të njëjtat pozicione, pavarësisht bindjes së tyre politike, gjë e cila është në një farë mënyre e prezumueshme në komunitete të vogla si ky i Bashkisë Mat.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se diskriminimi politik i saj ka filluar që në momentin e emërimit të administratorit të forcës tjetër politike, nëpërmjet presionit që ankuesja të jepte dorëheqjen, nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim i hapur dhe abuzim me të drejtën e fjalës. Në asnjë rast nuk provohet ky pretendim. Gjatë periudhës së zgjatjes së marrëdhënieve të punës me administratorin e ri, ankuesja ka patur një sjellje aspak etike me eprorin e saj, duke u përpjekur t’u intimidojë me forma të ndryshme të presionit. Për këtë arsye, ankueses i janë bërë tërheqje vëmendje, jo me qëllimin për të marrë masë disiplinore ndaj saj, por për të mundësuar reflektimin e saj kundrejt eprorit. Ankuesja i është drejtuar shpesh herë eprorit të saj me shprehje si “kalama”, “i paaftë”, apo duke komentuar notat e shkollës së mesme të administratorit, që nuk kanë asnjë lidhje me fjalorin dhe etikën në punë të një nëpunësi civil. Ankuesja me shprehjet dhe sjelljen e saj, nga njëra anë ka ofenduar eprorin direkt në më shumë se një rast, nga ana tjetër ka diskriminuar eprorin për shkak të moshës, dhe pse jo edhe për shkak të përkatësisë së tij politike, meqënëse ajo e konsideron atë të forcës tjetër politike, pavarësisht se për këtë ajo nuk paraqet asnjë provë dhe emërimi në këtë pozicion i administratorit nga Kryetari i Bashkisë nuk nënkupton domosdoshmërisht që ai të jetë anëtar i forcës politike të titullarit.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se sjelljet diskriminuese ndaj saj kanë filluar në datën 11.02.2020, kur administratori është rekomanduar që të bënte vlerësimin 6 mujor të punës, pavarësisht se ai kishte filluar punë në datën 24.11.2019, bashkia sqaron se, një detyrë e tillë parashikohet në nenin 62, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Administratori nuk ka bërë as më pak e as më shumë përveç zbatimit të kësaj dispozite ligjore dhe zbatimit të urdhërimeve të VKM-së nr.109/26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar. Pretendimi i ankueses se administratori nuk mund të kryente vlerësimin pasi kishte filluar punë në nëntor 2019, nuk ka asnjë bazë ligjore, pasi legjislacioni që rregullon këtë çështje dhe konkretisht VKM nr.109/26.02.2014, e ka përcaktuar qartësisht se, edhe nëse zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga puna, ata duhet të bëjnë vlerësimin e nëpunësit për periudhën gjatë së cilës kanë ushtruar detyrën dhe ky vlerësim merret për bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin përfundimtar. Në rast se kjo është e pamundur, zyrtari zëvendësues bazohet në vlerësimet e mëparshme. Sa më sipër, bashkia shprehet se dispozitat ligjore e urdhërojnë qartësisht administratorin në cilësinë e zyrtarit direkt, që të bëjë vlerësimin e vartësve të tij, pavarësisht kohës se kur ka filluar punë vetë ai.

Vlerësimi i ankueses është bërë në datën 10.01.2020 dhe ajo ka refuzuar që të ballafaqohet në lidhje me vlerësimin dhe të paraqesë kundërshtimet e saj. Nënshkrimi i ankueses në vlerësim është

bërë në datën 11.02.2020, fakt që tregon me vështirësitë që është ndeshur administratori në lidhje me procedurën e vlerësimit, për të cilën ankuesja duhet të nënshkruante qoftë edhe duke e kundërshtuar vlerësimin dhe jo të bënte manovra të çdo lloji duke neglizhuar dhe injoruar dukshëm eprorin direkt. Kundërshtimi i punonjësës është shqyrtuar konform ligjit dhe Sekretari i Përgjithshëm ka bërë vlerësimin sipas gjykimit të tij për rastin. Ndërkohë ankuesja nuk ka denjuar të njihet më tej me vlerësimin. Sa më sipër nuk mund të pretendohet se ankuesja është diskriminuar duke filluar nga data 11.02.2020 e në vijim. Për këtë pjesë të çështjes, provohet qartësisht se nuk ka asnjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe të pretenduar “bindja politike” dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë në dëm të ankueses, sikundër pretendohet. Kjo gjë provohet edhe me faktin se kolegë të tjerë të ankueses, të cilët ushtrojnë detyra të njëjta ose të ngjashme me ankuesen, janë trajtuar dhe është ndjekur e njëjta procedurë në lidhje me vlerësimin e punës dhe nuk ka patur asnjë kundërshtim pavarësisht nivelit të vlerësimit.

Në lidhje me çështjen e pretenduar të raportit të paaftësisë në punë, bashkia shprehet se është në vijim të sjelljes jashtë çdo norme etike të ankueses me eprorin direkt dhe që bie ndesh me rregullat e brendshme të bashkisë. Ankuesja nuk ka lajmëruar brenda ditës eprorin direkt. Ankuesja megjithëse me regjim shtrati, sipas rekomandimit të mjekut, gjen kohën që të shëtisë gjithë ditën në qytet, duke sfiduar eprorët, pasi meqënëse ka raport nuk kanë çfarë t’i bëjnë. Faktet tregojnë se ndaj saj nuk është marrë asnjë masë, për të respektuar raportin e lëshuar nga mjeku dhe nuk ka asnjë procedurë të filluar për këtë rast. Ankuesja ka marrë raporte mjekësore në disa raste, por ndryshe nga rasti i pretenduar në ankesë ka respektuar procedurën duke njoftuar eprorin për raportin brenda ditës. Për sa kohë që ankuesja nuk ka njoftuar eprorin direkt se është me raport, ai nuk ka patur si ta dinte dhe për rrjedhojë ka pasqyruar mungesën e ankueses në punë. Ndryshe ka ndodhur në rastet e tjera kur ankuesja ka njoftuar që ka qenë me raport. Për rrjedhojë Bashkia shprehet se nuk ka trajtim të padrejtë të ankueses.

Në lidhje me ankimet që ankuesja ka bërë për këtë situatë tek Sekretari i Përgjithshëm, bashkia sqaron se ajo është pritur në takim nga ky i fundit dhe i është sqaruar verbalisht në prani edhe të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, se nuk ka patur të drejtë pasi ndryshe nga rastet e tjera nuk ka njoftuar eprorin për raportin. Pra, ajo nuk është anashkaluar në kërkesën e saj ndryshe nga sa pretendon.

Në lidhje me kryerjen e punës në kushtet e pandemisë covid 19, bashkia shprehet se ato nuk janë të bazuara pasi Bashkia Mat ka zbatuar me korrektësi të gjitha udhëzimet e rastit të autoriteteve qendrore kompetente për të menaxhuar në shkallë vendi situatën e pandemisë covid 19. Po ashtu i pavërtetë është edhe pretendimi i ankueses se ndaj saj është ushtruar presion nga administratori për largim nga puna. Në bazë të urdhrit nr.156, datë 10.03.2020 “*Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid 19*”, nuk parashikohet mbyllja e bashkive, por është urdhëruar kufizimi i shërbimeve, duke respektuar protokollet. Bashkia ka proceduar me përshtatjen e orarit nga 08:00-16.00, në orarin e ri 08:00-13:00, si dhe kufizimin e shërbimit direkt nga zyrat e bashkisë aty ku është e mundur dhe orientimin e shërbimeve tek ZNN. Telepuna është zbatuar për sektorët që kanë shumë punonjës në zyrë, si dhe aty ku ekzistonte

mundësia praktike për ofrimin e shërbimeve *on-line*. Ato pak shërbime që mund të kërkoheshin në periudhën kulmore të pandemisë nuk përbënin rrezik të shtuar për askënd, përfshirë edhe ankuesen, në rast se protokollin për masat parandaluese të përhapjes së covid 19, do të respektohej. Bashkia ka bërë fushata sensibilizuese dhe informuese në këtë drejtim dhe ka marrë masa konkrete për dizinfektimin e mjediseve të punës, ofrimin e mjeteve mbrojtëse, e kështu me radhë. Nuk ka patur ndonjë rrezik të shtuar për asnjë nga punonjësit dhe masat e marra kanë qenë efektive në të gjithë Bashkinë Mat. Në rastin e ankueses duke qenë e vetme në zyrë, nuk ka qenë e nevojshme alternimi në punë dhe orarit me kolegët si dhe shërbimi për shkak të specifikave të pozicionit të punës, nuk mund të ofrohej online. Ato pak shërbime që mund të kërkoheshin në periudhën kulmore të pandemisë nuk përbënin rrezik të shtuar për askënd përfshirë edhe ankuesen, në rast se protokollin dhe masat parandaluese respektohen.

Në lidhje me pretendimet e ankueses për transportin, ashtu sikundër ankuesja janë shumë punonjës të tjerë të cilët kanë lëvizur me automjete çdo ditë nga njësitë administrative në drejtim të bashkisë në qytetin e Burrelit dhe në asnjë rast nuk ka patur ankesa, ndërkohë e kundërta ndodh në të gjitha rastet me ankuesen. Për këtë pjesë të çështjes, provohet qartësisht se nuk ka asnjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe të pretenduar “bindja politike” dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë në dëm të ankueses, sikundër pretendohet. Kjo gjë provohet edhe me faktin se kolegë të tjerë të ankueses, të cilët ushtrojnë detyra të njëjta apo edhe në pozicione të tjera, duke patur të njëjtën largësi nga vendi i punës, nuk është paraqitur asnjë rast ankimi të ngjashëm me të ankueses, pavarësisht se ku banojnë dhe ku ato ushtrojnë detyrat e tyre.

Në lidhje me transferimin dhe procedurën e ndjekur, bashkia shpjegon se procedura e ndjekur është bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në shërbimin civil, dhe nuk ka patur trajtim diferencues për ankuesen. Kjo sipas bashkisë provohet me faktin se disa punonjës të tjerë të cilët për nevoja të institucionit dhe jo vetëm, janë transferuar. Kështu gjatë vitit 2020, janë transferuar në pozicione të ndryshme punonjësit V.M, V.T, M.D, N.O, E.B dhe M.B. Të gjithë këta punonjës janë përballur me të njëjtat probleme të lëvizjes nga vendbanimi drejt pozicioneve të reja ku janë transferuar, por asnjëri prej tyre nuk është ankuar. Kjo për faktin se janë respektuar kërkesat e ligjit. Ndër punonjësit e transferuar ka patur edhe zonja, të cilat kanë përmbushur plotësisht detyrat në njësitë ku janë transferuar.

Transporti i personelit nga vendbanimi në vendin e punës nuk është i rregulluar me ligj apo akt nënligjor, sikundër në rastin konkret është VKM nr.125, datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”. Edhe nëse i referohemi Kodit të Punës, nuk ka ndonjë sqarim ku ankuesja bazon pretendimin e saj. Sipas nenit 126, të Kodit të Punës, punëdhënësi rimburson punëmarrësin për të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga kryerja e punës dhe kur punëmarrësi dërgohet të punojë jashtë vendit të tij të punës, punëdhënësi i paguan atij shpenzimet e nevojshme. Në rastin konkret për punën e kryer, punonjësja merr pagën sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe nuk kemi shpenzime të tjera që rrjedhin nga kryerja e punës për punëdhënësin, Bashkia Mat. Gjithashtu, në pozicion që ankuesja ka ushtruar detyrën, nuk kemi të bëjmë me ushtrimin e detyrës jashtë vendit të punës, pasi vendi i punës i çdo specialisti, nuk është i

lidhur me karrigen ose një zyrë fikse, por është në territorin ku shtrihet juridiksioni i bashkisë. Veprimtaria e stafit të bashkisë është dinamike dhe përfshin gjithë territorin e bashkisë si dhe njësitë administrative që janë pjesë përbërëse e saj.

Në stafin e bashkisë ka punonjës të cilët nuk e kanë vendbanimin afër vendit të punës dhe nuk është ngritur problem transporti, pasi nuk parashikohet se punëdhënësi merr përsipër shpenzimet që lidhen me lëvizjet nga vendbanimi në vendin e punës dhe anasjelltas. Ankuesja ka qenë brenda territorit të bashkisë dhe sikundër çdo ditë e bëjnë të njëjtën gjë pjesa më e madhe e stafit të bashkisë. Bashkia nuk ka asnjë detyrim për të siguruar transportin e personelit dhe të ankueses për në vendin e punës dhe anasjelltas nga vendi i punës për në vendbanim. Në këtë mënyrë bashkia pretendon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme apo të pabarabartë. Bashkia shprehet se ankuesja është trajtuar në çdo rast sikundër kolegë të saj, por në çdo pretendim të saj ajo shprehet se diskriminohet për shkak të bindjeve politike. Ankuesja ka patur mundësi që të ankohet në rrugë gjyqësore për transferimin e përkohshëm, por nuk e ka bërë. Ajo e ka pranuar transferimin faktikisht.

Procedurat e largimit nga puna nuk kanë filluar kur një anëtar i familjes së saj ka qenë i prekur me Covid 19. Procedimi disiplinor ka filluar shumë më herët në kohë dhe nuk ka patur lidhje me situatën e pandemisë. Konkretisht procedimi disiplinor ka filluar në datë 07.12.2020 me njoftimin me shkresën nr.5349 prot., datë 07.12.2020 “*Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore*”. Shkresa që vërteton pozitivitetin e vazhës së ankueses me covid mban datën 10.02.2021, pra shumë larg nga data e fillimit të procedurës disiplinore. Në lidhje me raportet mjekësore që ajo ka paraqitur në numër të pakufizuar, Komisioni i Disiplinës ka proceduar me pezullimin e afateve dhe në seancën përfundimtare ankuesja ka qenë prezent. Në lidhje me diagnostikimin me Covid 19 të Administratorit të Njësisë Administrative Lis, bashkia sqaron se ai gjatë kohës së seancave nuk ka qenë i prekur me covid, por më vonë, pasi procedura në komision kishte përfunduar dhe sipas protokolleve të mbrojtjes nga Covid 19, komunikimet janë zhvilluar në distancë brenda çdo rregulli të sigurisë së shëndetit.

Për sa i përket pretendimit për diskriminim të ankueses në shkresën e datës 24.02.2020 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, është proceduar me komunikime direkte me ankuesen dhe i është kërkuar që të paraqitet për sqarime në formë verbale apo edhe prova nëse kishte. Në vijim ankuesja është paraqitur vetëm pas tërheqjes së vëmendjes për dhënie mase disiplinore, sikundër konfirmohet edhe nga bashkëbisedimi i datës 02.03.2020, ku nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm i është bërë me dije ankueses se nuk provoheshin pretendimet e saj për diskriminim politik, por ajo duhet të tregojë me e sjellshme në punë dhe në marrëdhënie me eprorin.

Bashkia Mat informon se çështja po ndiqet gjyqësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas saj, në kërkesë padinë e saj ankuesja në më shumë se një rast ka trajtuar dhe ka kërkuar njohjen e diskriminimit, gjatë procedurës për marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, nga ana e Komisionit të Disiplinës. Pra, ankuesja çështjen e diskriminimit e ka bërë objekt gjyqësor dhe për këtë arsye në kuptim të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga*

Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 33, pika 7/4, Bashkia Mat kërkon që Komisioneri të vendosë për pushimin e çështjes.

Përfundimisht Bashkia Mat, pretendon se nuk vërtetohet në asnjë moment se jemi në kushtet e diskriminimit të ankueses për shkak të bindjeve të saj politike dhe se nuk ka asnjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar binjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë në dëm të ankueses. Përfundimisht Bashkia Mat kërkon nga Komisioneri që të mos e pranojë ankimin pasi është i pabazuar në prova dhe fakte.

2. Me shkresën nr.609/3 prot datë 26.05.2021, ankuesja ka depozituar dokumenta shtesë në mbështetje të ankesës. Me shkresën nr.856 prot datë 03.06.2021, ankuesja ka paraqitur kundërshtimet e saj në lidhje me shkresën nr.1815/1 prot datë 11.05.2021 të Bashkisë Mat, duke parashtuar ndër të tjera se:

Të gjitha pretendimet e ngritura nga Bashkia Mat janë justifikime, pasi ky institucion ka shkëmbyer një seri shkresash me ankuesen gjatë vitit 2020-2021, në përmjet të cilave ajo ka kërkuar që të distancohen nga diskriminimi i saj politik. Ankuesja thekson se ka paraqitur ankesën kundrejt Njësisë Administrative Lis, pasi inicimi i të gjitha shkresave kundrejt saj nisnin prej saj dhe mbajnë firmën dhe vulën e Administratorit të Njësisë Administrative dhe miratohen nga drejtuesit e Bashkisë Mat.

Në lidhje me bindjet e saj politike, ankuesja thekson se dokumentacioni i paraqitur prej saj me firmën e Kryetarit dhe Sekretarit të Partisë Demokratike Dega Mat provon plotësisht pretendimin e saj. Përveç të tjerave, sipas ankueses Bashkia Mat është bashki e vogël dhe bindjet politike janë të dallueshme. Lufta politike ndaj administratës dallohet qartë, duke u ndalur vetëm në Njësinë Administrative Lis. Sipas ankueses punonjësit e kësaj njësie U.K Administrator i Njësië, A.K specialist i ndihmës ekonomike, E.M, punonjës i zyrës me një ndalesë dhe A.Ç, sanitare, si dhe ankuesja janë zëvendësuar respektivisht me K.M, Administrator i Njësisë, A.A, specialiste e ndihmës ekonomike, B.K punonjës i zyrës me një ndalesë dhe S.B sanitare. Punonjës të tjerë që kishin varësi në qendër por mbulonin Njësinë Administrative Lis, si B. S, specialist i mbrojtjes së pyjeve, A.K, punonjës shërbimesh, B.C hidraulik, N.M, mirëmbajtës rrugësh, janë larguar gjithashtu nga puna.

Në lidhje me vlerësimin e punës, ankuesja thekson se gjatë muajit janar ka qenë me leje të zakonshme dhe vlerësimi i është dorëzuar me 11.02.2020. Vlerësimi është kundërshtuar nga ana e saj me shkresë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm me datë 15.02.2020 dhe administratorit me shkresën nr. 65 prot, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Me shkresën e datës 24.02.2020 ankuesja sqaron se i është drejtuar përsëri Sekretarit të Përgjithshëm. Sipas ankueses, eprori paraardhës nuk ka bërë asnjë vlerësim të punës së saj.

Në lidhje me mospagesën e raporteve mjekësore, ankuesja shpjegon se raportet mjekësore për periudhën 15.02.2020-22.02.2020 nuk i janë paguar me pa të drejtë. Pretendimi i eprorit se raporti

nuk i ka shkuar brenda ditës është i pabazuar pasi data 15.02.2020 ka qenë e shtunë dhe se në datën 17.02.2020 në orën 10:00 raporti mjekësor është dorëzuar.

Për sa i përket punës së kryer në kushtet e pandemisë, ankuesja shpjegon se ka punuar në një zyrë me përmasa 2 me 3, së bashku me punonjës in me një ndalesë dhe se bashkia bie në kundërshtim me urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë nr.156, datë 10.03.2020, pasi ajo ka qenë e detyruar të shkojë çdo ditë në punë në Lis, kur të gjithë ishin në karantinë. Ankuesja shpjegon se ka qenë e detyruar të përshkojë rrugën për në punë gjysëm në këmbë dhe gjysëm me makinë, pasi bashkia nuk mundëson transport dhe makinat që lëviznin në kushtet e pandemisë ishin shumë të rralla si pasojë e masave parandaluese. Krahasimi i bashkisë me komunat e tjera është i pavërtetë sepse punonjësit e Njësive Administrative të përmendura, Rukaj, Derjan dhe Macukull janë banues të njësisë.

Sipas ankueses, transferimi është kryefjala e luftës politike ndaj saj, duke transferuar një grua 55 vjeçe, me 25 vite punë në njësinë më të largët të bashkisë, pa transport urban, pa infrastrukturë rrugore, me zyra të shkatërruara, pa tualet e ujë dhe me fshatra të largëta nga qendra e njësisë. Transferimi është bërë në periudhën e verës që të mos kishte mundësinë të udhëtonte as me furgonin e mësuesve, të vetmin transport që ka kjo njësi.

3. Në vijim, me shkresën nr.609/4 prot dtë 25.06.2021, ankuesja ka depozituar parashtrime shtesë duke kundërshtuar përgjigjen e dërguar nga Bashkia Mat me shkresën nr.1815/1 prot datë 11.05.2021, ku ndër të tjera shprehet se:

Emrat e punonjësve të përfshirë në planin vjetor të mobilitetit për vitin 2021, nuk janë të rastësishëm për Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Kryetarin e Bashkisë Mat. Drejtori i Burimeve Njerëzore, sipas ankueses ka patur informacion për bazën e të dhënave të PD Dega Mat pasi ka qenë për një periudhë drejtues i Departamentit të Burimeve Njerëzore të PD Dega Mat. Në momentin që Bashkia Mat kaloi majtas, z. G.P, paraqiti dorëheqjen me shkrim para kryesisë së PD. Ankuesja shprehet se nuk është e panjohur edhe për Kryetarin e Bashkisë, pasi vijnë nga e njëjta zonë, kanë drejtuar fushata secili në kampin e vetë politik.

Transferimi në Njësinë Administrative Rukaj dhe jo në Ulëz, ky i fundit një nga variantet e parashikuara në planin e mobilitetit, në periudhën e verës kur nuk ka mjete transporti, është i qëllimshëm. Bashkia mund ta kishte transferuar në Njësinë Administrative Ulëz, ku transporti ishte më i sigurt.

Në lidhje me vlerësimin e punës për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 për të cilin ka marrë dijeni në datën 11.02.2020, përveç kundërshtimit me shkresa drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në datat 15.02.2020 dhe 24.02.2020, i është drejtuar edhe Kryetarit të Bashkisë më datë 05.05.2020 dhe 10.07.2020.

Për sa i përket dy urdhrave dhe vendimeve të nxjerra nga kryetari i Bashkisë që kanë të bëjnë me planin e masave të parandalimit të Covid 19, ankuesja shprehet se në kundërshtim me këto parashikime ajo ka punuar së bashku me punonjësin tjetër E.M, punonjësi i zyrës me një ndalesë në një në një ambient 2x3 dhe nuk është zbatuar telepuna. Kur vendi ishte në izolim dhe në kulmin e pandemisë, nën presionin e largimit nga puna është detyruar të shkojë çdo ditë në Lis. Sipas ankueses punonjësit e tjerë të Njesisë Administrative Lis ishin banorë të kësaj njësie dhe në këto kushte asnjë punonjës tjetër banues në qytetin e Burrelit nuk ka shkuar në këtë periudhë në fshat. Ankuesja pretendon se puna e saj mund të bëhej edhe me telepunë, pasi hipotekat, gjykatat, gjendja civile kanë qenë të mbyllura. Bazuar në vendimet e qeverisë edhe për shkak të moshës ankuesja thekson se ajo duhet të kishte punuar me telepunë.

Shkresat që kanë lidhje me transportin, të paraqitura nga Bashkia Mat, bien ndesh me veten tek orari, pasi makinat nga fshatrat e komunës në mëngjes vijnë nga fshati në Burrel dhe pasdite kthejnë nga Burreli në fshatra dhe se Bruç (qendra e Njesisë Administrative Rukaj) – Burrel nuk funksionon në këtë mënyrë. Është Zyra e Urbanistikës në Bashki e cila ka distancat e sakta, ndërsa bashkia ka paraqitur listën e transportit të mësuesve. Sipas ankueses, distanca Burrel-Lis është 15 km, ndërkohë që distanca Burrel-Bruç është 25 km dhe infrastruktura rrugore ka ndryshime të mëdha, pasi në Lis rrugët janë të asfaltuara në ndryshim nga Bruçi.

Ndryshe nga sa pretendon bashkia, ankuesja deklaron se e ka kundërshtuar transferimin me shkresa zyrtare, por nevojat ekonomike dhe mosha e saj për plotësimin e viteve për pension e detyruan që të shkojë gjatë gjithë verës në Bruç. Transferimi nuk ishte për përmirësim sikundër pretendohet por një torturë në muajt e verës me temperatura të larta dhe në valën e pandemisë.

4. Me shkresën nr.999/1 prot., datë 07.07.2021, ankuesja depozitoi kopje të konkluzioneve përfundimtare që kishte paraqitur në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të hapur prej saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar se pretendimet për diskriminim politik objekt i kësaj ankese nuk janë pjesë e procesit gjyqësor. Ankuesja informoi se në datën 06.07.2021 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë kishte shpallur vendimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit të Disiplinës së Bashkisë Mat, për lirim të saj nga shërbimi civil.
5. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”⁴, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 999 prot., datë 30.06.2021, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 16.07.2021.

Seanca u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të përfshira në procedurën administrative. Ankuesja D.K u paraqit personalisht prezent, Bashkia Mat, përfaqësuar me autozim nr.3232 prot datë 16.07.2021, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Mat, nga G.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së

⁴ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*”

Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe z. K.M, Administrator i Njesisë Administrative Lis, i cili në bazë të autorizimit të sipërcituar është autorizuar edhe si përfaqësues i Bashkisë Mat.

Gjatë seancës dëgjimore, palët mbajtën të njëjtin qëndrim të parashtruar paraprakisht nëpërmjet komunikimit shkresor me Komisionerin. Palës ankuese iu la detyrë që të depozitonte kopje të vendimit të gjykatës, në mënyrë që Komisioneri të vlerësonte pretendimin e paraqitur nga Bashkia Mat për pushimin e ankesës sipas pikës 7/4, të nenit 33, të LMD-së.

Ankuesja informoi Komisionerin se ishte në pamundësi që të depozitonte kopjen e vendimit të gjykatës pasi vendimi nuk ishte depozituar në sekretarinë e gjykatës.

6. Me shkresën nr.999/3 prot., datë 20.09.2021, Komisioneri kërkoi informacione shtesë nga ana e Bashkisë Mat dhe Njesisë Administrative Lis. Bashkia Mat ktheu përgjigje me shkresën nr.4115/1 prot., datë 18.10.2021⁵, duke parashtruar :

Bashkia Mat nuk kishte marrë dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës. Në lidhje me statusin e punësimit apo pozicionet e punës për nëpunësit civil të cilët i janë nënshtruar transferimit të përkohshëm gjatë vitit 2020, bashkia informon se, të gjithë vijnë të jenë në marrëdhënie pune dhe gëzojnë si më parë statusin e nëpunësit civil në të njëjtat pozicione që kanë qenë fillimisht. Këta punonjës janë: N.O, specialist i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë në Njësinë Administrative Rukaj, M.B, specialist i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë në Njësinë Administrative Ulëz, M.D, specialist i kadastrës dhe tokës bujqësore në Njësinë Administrative Rukaj, V.T, specialiste e ndihmës ekonomike në Njësinë Administrative Burrel (ka konkuruar dhe është emëruar në mënyrë definitive në këtë pozicion), ndërsa punonjësja V.M, është transferuar për shkak të ristrukturimit në Njësinë Administrative Derjan.

Në vitin 2019, në Njësinë Administrative Lis është punësuar vetëm K.M në pozicionin Administrator dhe kanë qenë punonjës, E.M, specialist i zyrës me një ndalesë, ankuesja D.K me detyrë specialiste e kadastrës dhe tokës bujqësore, A.K, me detyrë specialist i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, U.K, me detyrë administrator, A.Ç, me detyrë sanitare e cila është larguar për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe Q.H me detyrë nëpunës i gjendjes civile. Marrëdhëniet aktuale të punës për punonjësit e mësipër janë si vijon: E.M, është tranferuar në një Njësi Administrative tjetër dhe me pas është larguar nga puna për shkak të braktisjes së vendit të punës, U.K është larguar nga puna për mospërmbushje të detyrave funksionale, A.K është larguar me kërkesën e tij, dhe së fundmi po me kërkesën e tij është larguar Q.H. Punonjësit e rinj të emëruar janë : A.A, në pozicionin specialiste e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë për shkak të vakancës së krijuar nga largimi i A.K, B.K është emëruar në pozicionin specialist i zyrës me një ndalesë për shkak të vakancës së krijuar nga largimi i E.M, I.M është emëruar në pozicionin nëpunës i gjendjes civile për shkak të vakancës së krijuar nga Q.H i dorëhequr., S.B është emëruar sanitare, pasi pas

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1438/1 prot., date 20.10.2021.

kontaktimit të ish punonjësës A.Ç, kjo e fundit nuk ishte e disponueshme, ndërsa pozicioni i punës së punonjësës së kadastrës dhe tokës bujqësore është vakant.

Për transferimin e përkohshëm të ankueses, Bashkia Mat është bazuar në vlerësimet e punës për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 dhe ecurinë vijuese të punës për pjesën e parë të vitit 2020. Transferimi i ankueses është bërë në të njëjtën kategori, në përputhje me nenin 48, pika 1, të ligjit nr.152/2012 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Njësia Administrative Rukaj është zgjedhur për transferimin e ankueses pasi kishte pozicion specialisti të ngjashëm dhe me statusin e nëpunësit civil, ndërsa Njësia Administrative Ulëz nuk e kishte një pozicion të tillë me status nëpunësi civil.

Bashkia thekson se, auditi apo çdo organ tjetër i ngjashëm me të nuk ka të drejtë dhe tagër të bëjnë vlerësimin e punës për asnjë punonjës, por konstatojnë zbatimin e ligjshmërisë nga punonjësit në fushën e kompetencës. Vlerësimet e punës behën vetëm nga eprori direkt dhe ka disa komponentë, si realizimi i objektivave periodik 6-mujor dhe sjellja profesionale, e cila ka disa komponentë si realizimi në kohë i punës, kolegjialiteti i marrëdhënieve, gadishmëri për punë në grup etj. Ndërkohë që për periudhën në fjalë, të paktën për tre muaj në pozicionin e ankueses ka punuar një punonjës tjetër, që nënkupton që puna është bërë nga punonjës të tjerë dhe jo vetëm nga ankuesja në lidhje me pozicionin e specialistes së kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Lis.

Bashkia hedh poshte pretendimet e ankueses në lidhje me luftën politike dhe largimin e punonjësve, duke parashtruar se: U.K me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Lis është larguar nga puna për mospërmbushje të detyrave funksionale dhe nuk e ka kundërshtuar aktin e largimit nga detyra; A.K, specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë është larguar nga detyra me kërkesën e tij, për shkak të angazhimeve të punës në sektorin privat; E.M me detyrë specialist i Zyrës me një Ndalesë, është transferuar në një njësi tjetër administrative; A. Ç, me detyrë punonjëse shërbimesh, është larguar nga detyra për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe nuk ka bërë ankim; B.S, njëkohësisht vëllai i ankueses, ka qenë punonjës i pyjeve (me arsim të mesëm), njësi e cila nuk ka qenë pjesë përbërëse e administratës dhe më pas e gjithë njësia është shkrirë si strukturë dhe janë larguar të gjithë punonjësit, përfshirë dhe B.S. Pra nuk ka patur ndonjë diferencim me punonjësit e tjerë; A.K, nuk ka qenë pjesë e administratës së bashkisë dhe nuk ka mbuluar kurrë me asnjë lloj detyre në Njësin Administrative Lis, sikundër sajton ankuesja; B.Ç, nuk ka patur asnjë lidhje me bashkinë, aq më pak me profesionin që përmend ankuesja, N.M, vazhdon të jetë punonjës pranë bashkisë dhe është e pavëretetë ajo që pretendon ankuesja për largimin e tij.

Bashkia thekson se për shkak të numrit të kufizuar të punonjësve në Njësinë Administrative Lis dhe hapësirave të mjaftueshme, telepuna nuk ishte kusht i domosdoshëm për ankuesen dhe punonjësit e tjerë në këtë njësi, sipas protokollit anti-covid 19 në fuqi.

Në lidhje me transferimin, procedura ka qenë ligjore dhe normale, sikundër është vepruar për punonjës të tjerë. Qëllimi nuk ka qenë lufta politike, por përmirësimi i performancës së saj në punë dhe në vecanti atë pjesë që ka lidhje me sjelljen dhe etikën në punë. Pretendimet e ankueses në

lidhje me moshën, CV, nuk kanë lidhje me procedurën, pasi ligji nuk parashikon diferencime në lidhje me këta faktorë.

Në lidhje me pretendimet e ankueses për planin e mobilitetit të vitit 2021, bashkia, prapëson duke parashtruar se, plani i mobilitetit nuk bëhet mbi bazë emrash. Në lidhje me pretendimet e ankueses ndaj G.P, Drejtor i Burimeve Njerëzore, ky i fundit nuk e ka mohuar asnjëherë përkatësinë e tij politike, ndërsa është e pavërtetë se ka qenë drejtues i Departamentit të Burimeve Njerëzore të PD-së Dega Mat. Ankuesja nuk e provon se ka qenë anëtare e kryesisë së PD pas vitit 2013 dhe kjo provon se militancën partiake e ka të lidhur me interesat personale, pasi është e provuar që ajo nuk ka patur ndonjë angazhim politik në PD pas vitit 2013. Sipas dëshmive të vetë G.P, ai nuk ka paraqitur kurrë dorëheqjen pranë kryesisë së PD, pasi bashkia kaloi majtas. Pjesa vijuese e ballafaqimeve politike me Kryetarin e Bashkisë (aktiviteti politik i të cilit është pas vitit 2014, kohë që përkon me dorëheqjen e ankueses nga funksionet politike) dhe fitoret e ankueses, nuk është gjë tjetër veçse vijim i përpjekjeve për “lartësim” individual, që provojnë vijimësinë e gënjeshtreve të saj, ku nga njëra anë deklaron se ka dhënë dorëheqjen nga funksionet politike dhe nga ana tjetër paraqet skenar “betejash” të lavdishme.

Për sa i përket transportit dhe largësisë me vendin e punës gjatë transferimit, bashkia thekson se, distanca e Burrelit nga Njësia Administrative Ulëz është rreth 25 km, ndërsa në Njësinë Administrative Rukaj është rreth 20 km, pra është më afër vendi i punës ku është transferuar ankuesja se sa ai i pretenduar dhe është njësi ku kalon aksi kombëtar për në Rrëshen. Klasifikimi nga ankuesja i Njësisë Administrative Rukaj si zonë e thellë, është perceptim personal i saj, por nuk ka lidhje me realitetin.

Bashkia Mat, sqaron se vlerësimi i punës nuk është depozituar tek Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi nuk është nënshkruar nga ankuesja. Vlerësimi ka qenë në shqyrtim tek Sekretari i Përgjithshëm për ballafaqim me ankuesen, e cila nuk ka pranuar të bëjë këtë gjë. Pretendimi i ankueses se diskriminimi i saj ka filluar në datë 11.2.2020, është i pavërtetë dhe nuk ka asnjë bazë ligjore.

Bashkia thekson se, ndyshe nga sa pretendon ankuesja, ka shumë raste të punonjësve të cilët janë me banim në Burrel dhe kanë shkuar në punë në Njësinë Administrative Lis, konkretisht, Q.H, nëpunës i gjendjes civile Lis, me banim në Burrel i cili ka shkuar çdo ditë në punë, B.K, specialist i zyrës me një ndalesë në Njësinë Administrative Lis, i cili po ashtu është me banim në Burrel dhe është paraqitur çdo ditë në punës, A.A, specialiste e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë në Njësinë Adm.Lis dhe banuese në Shoshaj. Të gjithë këta punonjës janë paraqitur çdo ditë në punë pa asnjë lloj shqetësimi dhe në asnjë rast nuk janë ankuar në lidhje me situatën e pandemisë apo ndonjë gjë tjetër. Bashkia sjell edhe shembuj të punonjësve të cilët në kushte të ngjashme me ankuesen por me të vetmin ndryshim atë të drejtimit të lëvizjes për në vendin e punës, jo nga Burreli në Lis por nga Lisi në Burrel janë edhe punonjësit, M.B, specialiste e burimeve njerëzore banuese në Lis dhe vendi i punës në Burrel, S.K, Kryeinspektor i IMT-së, A.C, specialiste e pronave, E.M, specialiste e urbanistikës, apo të tjerë punonjës si K.Xh specialist i strehimit në Bashkinë Mat, i cili është me

banim në Bruc. Pra nuk ka patur asnjë trajtim të diferencuar të ankueses nga punonjës të tjerë apo ndonjë rrezik të shtuar për shëndetin e asnjë punonjësi.

Bashkia sqaron se, transporti publik ndërqytetas dhe në Njësitë Administrative ofrohet nga sektori privat. Oraret janë të plota gjatë gjithë ditës, ndërsa distancat janë lehtësisht të provueshme dhe është Sektori i Infrastrukturës që mbulon problematikën dhe Sektori i Urbanistikës nuk ka asnjë lidhje me këtë çështje, ndryshe nga sa pretendon ankuesja. Nga ana tjetër bashkia nuk ka asnjë detyrim ligjor që t'iu sigurojë punonjësve transportin nga vendbanimi për në vendin e punës.

7. Me shkresën nr.1430/2 prot., datë 1.11.2021, pranë Komisionierit u administruan kundërshtimet e ankueses në lidhje me shkresën nr. 4125/1 prot., datë 18.10.2021 të Bashkisë Mat, në të cilën parashtrohet:

Fillimi zyrtarisht i diskriminimit politik në datën 11.2.2020 lidhet me momentin kur Administratori i Njësië Administrative Lis i ka komunikuar vlerësimin e punës për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, i cili mban datën 10.1.2020. Gjatë shqyrtimit të ankesës, bashkia ka paraqitur dy vlerësime pune, të cilat sipas ankueses nuk kanë qenë në dosjen e saj personale dhe me të cilat ajo është njohur për herë të parë kur i janë komunikuar aktet e bashkisë nga ana e Komisionierit. Ankuesja thekson se në muajin janar 2020 ka qenë me leje të zakonshme dhe nuk ka qenë prezent që të refuzonte vlerësimin, fakt ky që provohet nga liztëprezenca në punë e muajit janar 2020. Vlerësimi i punës është kundërshtuar nga ankuesja me disa shkresa zyrtare, por bashkia nuk i ka kthyer asnjë përgjigje.

Në lidhje me periudhën e punës gjatë muajve mars dhe prill 2020, në kulmin e pandemisë, ankuesja kundërshton pretendimet e bashkisë në lidhje me dy punonjësit e tjerë të Njësisë Administrative Lis, B.K dhe A.A. Ankuesja thekson se punonjësi B.K nuk ka qenë në marrëdhënie pune gjatë muajve mars dhe prill 2020, sikurse rezulton nga listëprezenca e këtyre muajve por edhe akti i emërimit në punë, ndërsa punonjësja A.A sipas saj ka punuar gjatë gjithë kohës me telepunë, pasi ka tre fëmijë të mitur dhe ka qenë pjesë e komisionit të shpërndarjes së ndihmave në komunitet.

Sipas ankueses në një zyrë me përmasa 2 me 3 m² nuk mund të ruhet distanca e kërkuar sipas protokolleve mbrojtëse ndaj covid 19, ndërkohë që thekson se për atë dhe punonjës të zyrës me një ndalesë nuk mund të zbatohet telepunja, pasi të dy këta punonjës ishin në listën e largimeve politike nga puna.

Në datën 8.7.2020, pa asnjë bazë ligjore dhe logjike njerëzore bashkia ka nxjerrë urdhrin e transferimit nga Njësia Lis në Njësinë Rukaj. Transferimi është bërë në një zonë të thellë, pa infrastrukturë rrugore, pa linjë urbane, në kohë pandemie, ku fshati Urakë ishte zonë e kuqe në atë periudhë. Ankuesja shprehet se e ka kundërshtuar transferimin me shkresë zyrtare më datë 10.7.2020 drejtuar Kryetarit të Bashkisë, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Burimeve

Njerëzore, por nuk ka marrë përgjigje, ku ndër të tjera ka theksuar se ndaj saj është duke u ushtruar presion politik duke filluar nga data 11.2.2020. Ankuesja shprehet se është detyruar të shkoj në Njësinë Rukaj cdo ditë duke bërë 1 orë rrugë me makinë dhe 3 orë në këmbë vajtje ardhje, nga ora 6 e mëngjesit deri në 6 mbasdite, rreth 45 km vajtje ardhje. Është e vërtetë që fshati Urak përshkohet nga aksi Ura e Matit-Rrëshen, rrugë që kalojnë në të shumtën e rasteve makina të tonazhit të rëndë. Kjo rrugë nuk ka lidhje me transportin publik, për më tepër që bëhet fjalë për një vit ndryshe në kushtet e pandemisë. Sipas ankueses, në bazë të të dhënave të ARSH-së distanca Burrel-qendër administrative Lis është 15 km ndërsa Burrel –Urak është 15 km dhe Urak-Bruç (qendra e njësisë administrative) është 7.5 km, gjithsej 22.5 km. Në këtë mënyrë ankuesja thekson se është transferuar 15 km më shumë se në Lis dhe e gjithë rruga duhet të bëhet në këmbë. Asnjë nga shkresat e bashkisë nuk ka distanca të njëjta.

Ndryshe nga sa pretendohet nga bashkia, sipas ankueses spastrimi politik rezulton fare qartë në Njësinë Administrative Lis, ku spastrimi politik është 100%, fakt ky që rezulton nga listëprezenca e 2019 me atë të 2021. Në lidhje me B.S, thekson se do të largohet i pari pasi është i djethtë, por justifikimi i bashkisë është i pabazuar. B.S është teknik pyjesh që në vitin 1978 kur ka mbaruar teknikumin pyjor në Shkodër. Dokumentacioni i marrë nga gjykata tregon për punonjësit e tjerë që bashkia pretendon se nuk i njeh. Plani i mobilitetit nuk është i rastësishëm, pasi nëpërmjet tij bashkia kërkon të diskretitojë politikisht ish anëtarët e kryesisë së Partisë Demokratike, konkretisht: E.B, largohet nga puna në datë 10.10.2020, V.M, e cila ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, N.O, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Ciovil, si dhe vetë ankuesja.

8. Me vendimin nr.194, datë 12.10.2020, Komisioneri vendosi të pezullojë procedurën e shqyrtimit të ankesës, deri në sigurimin e kopjes së vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka disponuar në lidhje me kërkesë padinë e paraqitur nga ankuesja, me qëllim vlerësimin e kërimit të paraqitur nga Bashkia Mat, për pushimin e shqyrtimit të ankesës pasi ankuesja ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor të njëjtat pretendime për diskriminim të cilat i ka parashtruar përpara Komisionerit.
9. Pasi u administrua kopja e vendimit nr.2166, datë 6.7.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri arriti në përfundimin se, kërkesa e Bashkisë Mat për pushimin e çështjes, ishte e pabazuar, pasi ankesa e paraqitur për shqyrtim pranë Komisionerit nga ana e palës ankuese nuk është e njëjtë me kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e për rrjedhojë nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 33, pika 7/4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në këto kushte, me vendimin nr.17, datë 17.01.2022, Komisioneri vendosi, ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës administrative për shqyrtrimin e ankesës.

Me vendimin nr.2166, datë 6.7.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: *“Pranimin tërësisht të kërkesë-padisë administrative. Shfuqizimin si të paligjshëm të*

veprimit administrativ, të kryer prej palës së paditur Bashkia Mat, vendimi nr.01, datë 04.02.2021, si lëndë me përmbajtje të shkresës me nr.597 prot., datë 04.02.2021 për dhënien e masës disiplinore të largimit prej shërbimit civil, kundrejt palës paditëse, znj.D.K. Pala e paditur Bashkia Mat detyrohet të rregullojë pasojat e krijuara prej paligjshmërisë, për këtë duhet : (a) të rikthejë nëpunësin civil, në pozicionin e mëparshëm të punës, sipas ligjit me nr.152/2012 “Për nëpunësin civil” dhe (b) vijimin e pagimit të pagës deri në momentin e rikthimit në punë....”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja ka filluar punë pranë Bashkisë Mat më datë 01.07.2016, sipas vendimit nr.398, datë 01.7.2016 “Për komandim punonjësi” në pozicionin e specialistes së kadastrës të tokës bujqësore, pranë Njesisë Administrative Lis. Marrëdhënia e punës është rregulluar me kontratën individuale të punës, me afat të caktuar nr.1713 prot., datë 01.07.2016, për një periudhë 3 mujore dhe marrëdhëniet e punës kanë vijuar dhe pas përfundimit të këtij afati.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me shkresën nr.1518 prot., datë 19.06.2017 “Akt emërimi”, ankuesja është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin specialiste e kadastrës së tokës bujqësore pranë Njesisë Administrative Lis, Bashkia Mat. Me shkresën nr.1810 prot., datë 17.07.2018 “Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil” ankuesja është deklaruar nëpunëse civile, në këtë pozicion pune.

Bazuar në dosjen personale të ankueses rezulton se marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe Bashkisë Mat kanë vijuar normalisht dhe ndaj saj nuk rezulton që të jenë marrë masa disiplinore apo vlerësim negativ në lidhje me performancën e saj në punë.

Në datën 10.01.2020, z. K.M, Administrator i Njesisë Administrative Lis, në cilësinë e eprorit të drejtëpërdrejtë, ka bërë vlerësimin e performancës në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, ku ankuesja është vlerësuar me nivelin më të ulët të vlerësimit 4, “Jo kënaqshëm”.

Gjatë muajve mars dhe prill 2020, që shënojnë kulmin e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ankuesja është paraqitur çdo ditë në punë, duke udhëtuar nga qyteti i Burrelit, ku ajo është banuese, për në vendin e saj të punës në Njësinë Administrative Lis.

Në vijim, me vendimin nr. 469, datë 08.07.2020, të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mat, ankuesja është transferuar përkohësisht për një periudhë 3 mujore duke filluar nga data 13.07.2020 deri në 13.10.2020, për përmirësimin e rezultateve në punë, në pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Rukaj, Bashkia Mat.

Me shkresën nr. 5349 prot., datë 07.12.2020, të Komisionit të Disiplinës së Bashkisë Mat, ndaj ankueses ka filluar procedimi disiplinor për shkak se ajo nuk ka zbatuar dy urdhra të Kryetarit të Bashkisë. Konkretisht, urdhrin nr.119, datë 17.2.2020 “Për ngritjen e komisionit për verifikimin në terren të ankesës së paraqitur nga z. F. B. ndaj z. G. B.” dhe urdhrin nr. 120, datë 12.2.2020 “Për ngritjen e komisionit për verifikimin në terren të ankesës së paraqitur nga z. Xh. Q. ndaj z. A. Q”. Në përfundim të procesit disiplinor, me vendimin nr.01, datë 04.02.2021, Komisioni Disiplinor (KD), ka vendosur: “Marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil për nëpunësen civile znj. D.K me detyrë Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njesisë Administrative Lis, Bashkia Mat”. Me urdhrin nr. 54, datë 05.02.2021 “Për dorëzim detyre”, të Kryetarit të Bashkisë Mat, marrëdhëniet financiare kanë përfunduar në datë 12.02.2021.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, duke u ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm: *së pari*, trajtimin e saj gjatë marrëdhënieve të punës, duke përfshirë vlerësimin e rezultave në punë për 6 mujorin e dytë të 2019, kushtet e punës në kulmin e pandemisë, veçanërisht gjatë muajve mars dhe prill dhe transferimin e përkohshëm 3 mujor në Njësinë Administrative Rukaj; dhe *së dyti*, në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të punës dhe largimin nga shërbimi civil.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme; Në situata të caktuara, kur trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm vjen si pasojë e mosrespektimit dhe moszbatimit të standarteve dhe kërkesave të miratuara nga legjislacioni në fuqi, krahasuesi për qëllime të të provuarit të sjelljes diskriminuese mund të konsiderohet standarti apo kërkesa që nuk është respektuar dhe që ka sjellë si pasojë trajtimin e padrejtë. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuese, nuk është e nevojshme në çdo rast identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesat për të provuar se diskriminimi ka ndodhur konsiderohen të përmbushura edhe nga një krahasues hipotetik, që në rastin konkret është mënyra se si Bashkia Mat, duhet të kishte respektuar standartet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni që rregullon situatët e pretenduara nga ana e ankueses.
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji, në rastin konkret bindjet politike të ankueses.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesja i është nënshtruar trajtimit të të favorshëm në lidhje me pretendimet objekt shqyrtimi në këtë ankesë.

A/1 Në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë.

Rezulton se, ankuesja ka ushtruar detyrën si nëpunëse civile në pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Lis, në Bashkinë Mat dhe është konfirmuar si nëpunëse civile në datën 17.07.2018. Administratori i Njësisë Administrative z. K.M, në cilësinë e eprorit direkt, në datën 10.01.2020, ka bërë vlerësimin e performancës në punë të ankueses për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, duke e vlerësuar ankuesen me “Jo kënaqshëm”, që është vlerësimi më i ulët për nëpunësin civil. Bashkia Mat (Bashkia) dhe Administratori i Njësisë Administrative Lis (NjAL), pretendojnë se ankuesja ka kundërshtuar të marrë dijëni për vlerësimin e punës, ndërsa ankuesja pretendon se ka marrë dijëni për vlerësimin e punës në datën 11.02.2020, kur është kthyer nga leja e zakonshme.

Bazuar në listëprezencën për muajin janar 2020, me nr. 38 prot., datë 31.01.2020, të nënshkruar nga Administratori i Njësisë Administrative Lis dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mat, rezulton se gjatë muajit janar 2020, ankuesja ka qenë me leje të zakonshme për 20 ditë. Bashkia dhe Njësia nuk arritën të provonin datën ku kanë vendosur në dijëni ankuesen lidhur me vlerësimin e punës, ndërsa ankuesja pranon se ka marrë dijëni në datën 11.02.2020. Ankuesja

nuk e ka pranuar vlerësimin e punës dhe e ka kundërshtuar fillimisht pranë Administratorit me shkresë në datë 17.02.2020, por nuk ka marrë përgjigje. Më pas, në datë 24.02.2020 ankuesja i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Mat, duke i kërkuar anulimin e vlerësimit të punës të datës 10.01.2020, duke pretenduar se vlerësimi i bërë ishte diskriminues dhe se ankuesja po diskriminohej për shkak të bindjeve politike, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje. Sipas formularit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Mat, rezulton se Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat, pas rivlerësimit të bërë në cilësinë e zyrtarit autorizues, ka konfirmuar vlerësimin e bërë nga Administratori.

Vlerësimi i nëpunësit civil është një proces i rëndësishëm që sjell edhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet lirit nga shërbimi civil për shkak të rezultateve jokënaqshëm. Ky proces gjen rregullim në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar. Sipas pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit”.

Procedurat e hollësishme të vlerësimit të rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit të vlerësimit përcaktohen në VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar. Sipas pikave 1 dhe 3 të Kreut II, të VKM nr. 109, datë 26.02.2014, përcaktohet se: “1. Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë: a) është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik. b) shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirin nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.....3. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues.”

Sipas pikës 12, të Kreut II, të VKM nr. 109, datë 26.02.2014, përcaktohet se, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është i vazhdueshëm dhe konsiston në tri faza, planifikim, bisedimet e ndërmjetme dhe vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë.⁶ Nuk rezultoi se Administratori i

⁶ Pika 12, Kreu II, të VKM nr. 109, datë 26.02.2014: “12. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është i vazhdueshëm dhe konsiston në tri faza: a) **Planifikimi**: Zyrtari raportues përkatësisht për secilën periudhë vlerësimi, gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit dhjetor dhe gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit qershor takohet me nëpunësin që do të vlerësohet për të përcaktuar objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesorë. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional. b) **Bisedimet e ndërmjetme**: Në mes të periudhës së vlerësimit, zyrtarët raportues takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar

Njesisë Administrative Lis, në cilësinë e zyrtarit raportues të jetë takuar me ankuesen në cilësinë e nëpunësit që do të vlerësohet për të diskutuar në lidhje me objektivat e punës dhe arritjen e tyre nga momenti që ai ka marrë detyrën, duke marrë në konsideratë edhe faktin e marrjes së detyrës vetëm në dy muajt e fundit të periudhës së vlerësimit.

Në kreun III, pikat 6, 7 dhe 8, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, parashikohet se: “6. Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë së cilës kanë ushtruar detyrën. 7. Vlerësimi sipas pikës 6 të këtij kreu, merret si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar. 8. Në rast se marrja e vlerësimit sipas pikës 6 të këtij kreu, është e pamundur, zyrtari zëvendësues bazohet në vlerësimet e mëparshme”

Rezulton se, deri në datën 21.10.2019, në detyrën e Administratorit të Njesisë Administrative Lis ka qenë i emëruar z. U. K, të cilit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në bazë të urdhrit nr. 485, datë 21.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë Mat. Për rrjedhojë vlerësimi i ankueses për periudhën korrik deri më 21.10.2019, duhet të ishte realizuar nga ish Administratori i Njesisë Administrative Lis z. U. K., ndërsa z. K.M për periudhën pas datës 21.10.2019 deri në datë 31.12.2019. Nuk rezulton që të jetë respektuar kjo procedurë. Gjithashtu, Bashkia Mat nuk arriti të provojë se ka qenë në pamundësi që vlerësimi të kryhej nga ish administratori dhe ish zyrtari raportues z. U. K.

Nga aktet e administruara nuk rezultojnë vlerësime të mëparshme të ankueses, por ndërkohë rezulton se ecuria në punë e ankueses ka qenë normale dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës së ankueses me Bashkinë Mat, ndaj saj nuk është marrë ndonjë masë disiplinore. Administratori i Njesisë Administrative Lis ka kryer vlerësimin e ankueses me “jo kënaqshëm” në kundërshtim me pikën 12 të kreut II të VKM së sipërcituar dhe për një periudhë që nuk ka qenë në detyrë (korrik 2019-21.10.2019).

Bazuar në aktet e depozituara nga Bashkia Mat, rezulton se Sekretari i Përgjithshëm ka konfirmuar vlerësimin e bërë nga Administratori në datën 24.01.2020, duke deklaruar si vijon: “Vlerësimi i bërë nga eprori direkt është realist dhe nuk ka nevojë që unë të parashtoj rivlerësim tjetër. E konfirmoj vlerësimin e eprorit direkt, kjo për faktin se nëpunësja nuk po bashkëpunon”. Ky shënim është vendosur nga Sekretari i Përgjithshëm në formularin e vlerësimit ndarja DH: Rivlerësimi nga zyrtari autorizues, në datën 24.01.2020 dhe kur nuk rezulton sipas formularit që ankuesja të ketë marrë dijeni për vlerësimin e bërë nga administratori në cilësinë e zyrtarit raportues. Rivlerësimi i bërë nga Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e zyrtarit autorizues nuk rezulton që t’i jetë njoftuar ankueses.

për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.c) Vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë: Gjatë vlerësimit përfundimtar të rezultateve në punë, zyrtari raportues bën një vlerësim të përmblodhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesorë të punës, të përcaktuar në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme. Kjo fazë për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1–15 korrik dhe 1–15 janar.”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Ankuesja ka kundërshtuar vlerësimin e rezultateve në punë të bërë nga Administratori, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Mat, në datat 17.02.2020 dhe 24.02.2020, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Pretendimet se ankuesja ka refuzuar të marrë dijeni nuk kanë asnjë bazë, pasi detyrimi për të njoftuar nëpunësin civil në lidhje me procesin e vlerësimit të rezultateve të punës, kur ai ka paraqitur ankesë, qëndron mbi punëdhënësin, pra mbi Bashkinë Mat. Bashkia Mat nuk arriti të provojë se ka njoftuar ankuesen në lidhje me rivlerësimin, ndërsa ankuesja deklaroi se ka marrë dijeni në lidhje me vlerësimin nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm kur është njohur me dokumentacionin e depozituar nga bashkia gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit.

Bazuar në pikën 9, të Kreut IV të VKM nr. 109/26.2.2014, përcaktohet se: *“9. Ndarja DH e lidhjes nr. 2 plotësohet nga zyrtari autorizues kur nëpunësi nuk ka pranuar vlerësimin dhe ka kërkuar shqyrtim nga ana e zyrtarit autorizues. Ndarja DH e lidhjes nr. 1 plotësohet nga KKP-ja/ titullari i institucionit dhe nga nëpunësi që vlerësohet”*.

Sa më sipër rezulton se Sekretari i Përgjithshëm ka kryer rivlerësimin në datën 24.01.2020, ndërkohë që nuk ka patur asnjë ankesë, pasi rezulton se ankuesja ka marrë dijeni për vlerësimin e rezultateve në punë të 6 mujorit të dytë të 2019 në datën 11.02.2020.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Bashkia Mat vendosi në dispozicion të Komisionerit kopje të vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2020, ku ankuesja është vlerësuar në nivelin 3 “kënaqshëm”. Ankuesja ngriti pretendimin se nuk ka patur dijeni në lidhje me këtë vlerësim dhe ka marrë dijeni pasi iu vendosën në dispozicion për njohje aktet nga ana e Komisionerit. Referuar kopjes së vlerësimit të vendosur në dispozicion nuk rezulton që ankuesja të ketë nënshkruar formularin, si për sa i përket vlerësimit të bërë nga Administratori në datën 06.07.2020, ashtu edhe për rivlerësimin e bërë nga Sekretari i Përgjithshëm që mban datën 27.07.2020. Sekretari i Përgjithshëm në ndarjen e formularit të vlerësimit të emërtuar DH: Rivlerësim nga zyrtari autorizues deklaroi: *“Nuk ka rivlerësim sepse nëpunësja nuk ka paraqitur asnjë ankim dhe nuk ka pranuar të njihet me vlerësimin. E konfirmoj vlerësimin e eprorit direkt”*. Pretendimi se ankuesja ka refuzuar të marrë dijeni për vlerësimin nuk ka asnjë bazë, pasi detyrimi për të njoftuar nëpunësin civil në lidhje me procesin e vlerësimit të rezultateve të punës, qëndron mbi punëdhënësin, pra mbi Bashkinë Mat dhe strukturat e saj. Bashkia Mat nuk arriti të provojë se ka njoftuar ankuesen në lidhje me vlerësimin, për rrjedhojë pretendimi se ankuesja nuk ka bërë ankim është i pabazuar. Administratori i Njesisë Administrative Lis dhe Bashkia Mat nuk provuan se kanë njoftuar ankuesen për vlerësimin e kësaj periudhe, sipas përgjegjësive respektive në këtë proces.

Referuar Raport- Auditimit (Përfundimtar) të mbajtur nga Sektori i Auditit të Brendshëm të Bashkisë Mat në Njesisë Administrative Lis, në datë 18.12.2019, konstatohet se për periudhën e audituar 01.01.2017 – 31.12.2019, puna e ankueses vlerësohet e mirë nga administratorët. Ky Raport Auditimi (Përfundimtar) i është përcjellë me shkresën nr. 50 prot., datë 18.12.2019 Njesisë Administrative Lis.

Sa më sipër, rezulton se për të dy vlerësimet e punës, si për 6 mujorin e dytë të 2019, ashtu edhe për 6 mujorin e parë të 2020, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhat e sipërcituara nuk rezulton të jetë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon statusin e nëpunësit civil dhe është cënuar rëndë e drejta e ankueses për t'u njohur me vlerësimet. Procedura e ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses rezulton një procedurë plotësisht e njëanshme nga ana e punëdhënësit në mungesë totale të përfshirjes së nëpunësit civil.

A/2 Në lidhje me kushtet e punës gjatë pandemisë covid-19.

Rezulton e provuar se ankuesja është banore në qytetin e Burrelit dhe u pranua nga palët se, që nga momenti i shpalljes së epidemisë së shkaktuar nga Covid 19, në mars 2020, ankuesja është paraqitur çdo ditë fizikisht në vendin e punës, pranë Njësisë Administrative Lis. Ankuesja pretendon se një fakt i tillë bie ndesh me rregullat e vendosura për punën e administratës gjatë kësaj kohe dhe se ajo duhet të kishte punuar nga shtëpia. E gjendur nën presionin e vazhdueshëm të Administratorit, ankuesja deklaroi se është detyruar të paraqitet çdo ditë në punë, në kushtet e kufizimeve të lëvizjes të vendosura si pasojë e pandemisë dhe me rrezikun e shtuar të infektimit nga virusi, ndërsa një praktikë e tillë nuk është ndjekur për punonjës të tjerë të ndodhur në kushtet e saj, pra që banon larg qendrës së punës.

Me urdhrin nr. 156, datë 10.03.2020 *“Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid”*, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), pikat 4 dhe 5, është përcaktuar se: *“4. Institucionet publike dhe private, të hartojnë sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, brenda datës 11.3.2020, një plan masash për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare, duke prioritetizuar kategorinë e shërbimit kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit online, punës në distancë dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kontaktit fizik. Për shërbimet për të cilat nevojitet kontakti i drejtpërdrejtë me publikun institucionet duhet të pajisin punonjësit me mjete pune mbrojtëse me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre. Institucionet publike që ofrojnë shërbime pritjeje për publikun në sportel të marrin masa për të shfrytëzuar maksimalisht shërbimet online dhe platformën e-Albania. 5. Për shërbimet publike për të cilat kërkohet kontakt i afërt me publikun, institucionet duhet të pajisin punonjësit me mjete mbrojtëse, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre.”*. Me urdhrin nr. 223, datë 01.04.2020, të MSHMS, përcaktohet se, efektet e urdhrin të sipërcituar do të zbatohen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Me urdhrin nr. 178, datë 12.03.2020 *“Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid 19 për institucionet që ndodhen në territorin e Bashkisë Mat”*, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, në pikat 5 dhe 7 të tij është vendosur: *“...5. Drejtoritë dhe Sektorët në varësi të Bashkisë Mat të marrin masa që punonjësit të kenë një distancë prej 2 m largësi në vendin e punës së tyre, nëse kjo është e pamundur referuar numrit të*

punonjësve dhe ambienteve të zyrave, të merren masa për alternimin e punonjësve sipas ditëve, referuar nevojave të veprimtarisë së drejtorisë/vektorit.....7. Qytetarët për shërbimet që kërkojnë pranë Bashkisë Mat, të paraqiten vetëm pranë Zyrës me një ndalesë “One stop shop” të Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative me radhë për të mos krijuar një grumbullim të gjerë të qytetarëve në këto ambiente...”

Bazuar në VKM nr. 237, datë 20.03.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar, është vendosur: “Përjashtimisht nga sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreu, gjatë priudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19, orari i punës për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të administratës publike/shtetërore është 08:00-13:00. Nëpunësit civilë dhe punonjësit e përmendur në këtë pikë, gjatë kësaj periudhe, ngarkohen të kryejnë çdo detyrë funksionale që iu ngarkohet nga eprori i drejtëpërdrejtë apo titullari i institucionit, e cila mund të përmbushet në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit telefonik apo të mënyrave të tjera të komunikimit elektronik.” Parashikimi i mësipërm është shfuqizuar me VKM nr. 426, datë 01.06.2020.

Bashkia Mat pranoi se të gjithë punonjësit e Njësive Administrative Lis janë paraqitur fizikisht çdo ditë në punë, për shkak të numrit të vogël të punonjësve dhe hapësirave të mjaftueshme që lejonin respektimin e protokollit të mbrojtjes nga covid-19. Gjatë kësaj periudhe në përputhje me rregullimet e vendosura orari i punonjësve ka qenë 08:00-13:00 dhe është zbatuar njësoj për të gjithë punonjësit.

Bazuar në listëprezencat e muajve mars dhe prill 2020 të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, në Njësine Administrative Lis kanë qenë të punësuar këta punonjës: K.M, Administrator; A. A, Admin. Shoqëror; D.K, inspektore kadastre; E. M., specialist i zyrës me një ndalesë gjatë muajit mars 2020 dhe datat 1, 2, 3 të muajit prill 2020, B. K., për datat 27-30 prill 2020. Punonjësi i gjendjes civile pranë Njësive Administrative Lis, z.Q. H. nuk figuron në këto listëprezenca dhe as në listëprezencat e muajve janar dhe shkurt të administruara.

Bashkia nuk depozitoi prova për të vërtetuar se punonjësit e tjerë të Njësive Administrative Lis, B. K., A. A., Q. H. kishin vendbanim të ndryshëm nga qendra e tyre e punës. Deklaratat e punonjësve A. A. dhe B. K., se nuk janë banorë të Njësive Administrative Lis dhe kanë udhëtuar çdo ditë gjatë periudhës së epidemisë dhe se kanë qenë fizikisht në prezent në vendin e punës, nuk provojnë pretendimet e Bashkisë Mat në lidhje me vendbanimin e tyre, e për rrjedhojë që këta punonjës kanë qenë në të njëjtat kushte me ankuesen. Për punonjësin B. K., rezulton se, marrëdhëniet e tij të punës kanë filluar në katër ditët e fundit të muajit prill 2020 dhe për rrjedhojë ai nuk mund të konsiderohet në të njëjtat kushte me ankuesen, pasi nuk ka qenë në punë gjatë muajit mars dhe pothuajse gjatë gjithë muajit prill 2020, me përjashtim të katër ditëve të fundit të muajit. Z. K.M, Administrator i Njësive është banor i Njësive Administrative Lis, si detyrim i parashikuar nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Ankuesja pretendoi se të vetmit që janë paraqitur çdo ditë në punë

gjatë muajve mars-prill 2020, kanë qenë ajo dhe punonjësi E. M., punonjës i zyrës me një ndalesë, por ndryshe nga ankuesja, E. M. është banor i Njesisë Administrative Lis. Bashkia Mat nuk e kundërshtoi dhe nuk pretendoi se punonjësi E. M. është një rast i ngjashëm me ankuesen, pra që ka patur vendbanimin larg vendit të punës. Në lidhje me punonjës të tjerë të Bashkisë Mat, vendbanimi i të cilëve është i ndryshëm nga vendi i tyre i punës, por me drejtim të kundërt të lëvizjes me atë të ankueses, pra që u është dashur të udhëtojnë nga njësitë e tjera administrative për në qytetin e Burrelit ku gjenden zyrat e Bashkisë Mat, emrat e punonjësve të paraqitur nga Bashkia Mat të pashoqëruar me dokumentacionin përkatës në lidhje me vendbanimin e tyre ose pozicionet përkatëse të punës, nuk provojnë pretendimet e bashkisë.

Sa më sipër, Bashkia Mat nuk arriti të provojë pretendimin se ka patur punonjës të tjerë të cilët kanë qenë në të njëjtat kushte me ankuesen dhe janë trajtuar në të njëjtën mënyrë. Por nga ana tjetër ajo që rezultoi e provuar, duke u pranuar nga të dy palët është se, ankuesja është paraqitur çdo ditë fizikisht në vendin e saj të punës, duke udhëtuar nga qyteti i Burrelit në Njesisë Administrative Lis dhe anasjelltas. Ndaj ankueses, nuk rezulton të jetë zbatuar në asnjë rast alternativimi midis punës në zyrë dhe asaj nga shtëpia, ndërkohë që sipas VKM nr. 237, datë 20.03.2020, nëpunësit civilë, gjatë kësaj periudhe, ngarkohen të kryejnë çdo detyrë funksionale që iu ngarkohet nga eprori i drejtpërdrejtë apo titullari i institucionit, e cila mund të përmbushet në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit telefonik apo të mënyrave të tjera të komunikimit elektronik. Po ashtu, referuar urdhrin nr. 156, datë 10.03.2020 të MSHMS, kërkohet që shërbimet të prioritizohen, kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit online, punës në distancë dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kontaktit fizik. Nuk rezulton që Bashkia Mat të ketë miratuar me akt të veçantë prioritizimin e shërbimeve dhe mënyrës se si do të ofrohen ato.

Me urdhrin Nr. 168/1, datë 15.03.2020 *“Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit”*, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka urdhëruar: *“1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit publik dhe privat të udhëtarëve qytetas, ndërqytetas dhe rrethqytetas deri në një urdhër të dytë.”* Ndërsa me urdhrin nr. 168/2, datë 18.03.2020 *“Për kufizimin e lëvizjes me automjetet private ose shtetërore të administratës publike”*, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vendosur: *“1. Ndalimin e lëvizjes me automjetet private ose automjete shtetërore të punonjësve të administratës publike të institucioneve qendrore dhe atyre vendore, puna e të cilëve lidhet me qëndrimin në zyrë dhe jo në terren”*.

Referuar akteve të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, transporti publik dhe ai privat ka qenë i ndaluar dhe lehtësimi shërbimit të transportit, kryesisht atij taksi ka filluar në fund të muajit prill dhe me numër të kufizuar personash. Ndërkohë që transporti publik i udhëtarëve, qytetas, ndërqytetar dhe rrethqytetas, ka vazhduar të jetë i ndaluar edhe gjatë muajit maj 2020.

Bashkia Mat, nuk dha asnjë shpjegim se përse natyra e punës së ankueses mbarhte specifika të cilat nuk lejonin kryerjen e saj nëpërmjet punës në distancë ose për të krijuar mundësinë e kryerjes së

detyrave duke alternuar prezencën fizike dhe punën në distancë. Nga ana tjetër Bashkia Mat pranon se në periudhën kulmore të pandemisë shërbimet e kërkuara nga ankuesja kanë qenë të pakta. Bazuar edhe në përshkrimin e punës për pozicionin e punës të mbajtur nga ankuesja “*Specialiste e kadastrës dhe tokës bujqësore*” nuk konstatohen shërbime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht prezencën fizike të ankueses, veçanërisht në kushtet e pandemisë kur kërkohet shmangia e kontakteve fizike.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjatë muajve mars –prill 2020, periudhë e cila ka shënuar kulmin e masave kufizuese në kushtet e situatës së krijuar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ankueses duhet t’i ishin mundësuar forma alternative për të përmbushur funksionet e saj, sikurse është puna në distancë ose alternimi i saj me prezencën fizike. Sa më sipër, ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më të pafavorshëm, lidhur me kushtet e punës gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, për periudhën mars-prill 2020.

A/3 Në lidhje me transferimin e përkohshëm të ankueses nga Njësia Administrative Lis, në Njësinë Administrative Rukaj.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, me vendimin nr. 469, datë 08.07.2020 “*Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil*”, ankuesja është transferuar nga pozicioni i punës ku ka emërimin “*Specialiste e kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Lis*”, në pozicionin Specialiste e kadastrës së tokës bujqësore, në Njësinë Administrative Rukaj, me motivacionin për përmirësim të rezultateve në punë.

Rezulton se, kërkesa për transferimin e përkohshëm të ankueses është bërë nga Sekretari i Përgjithshëm, nëpërmjet shkresës nr. 2317 prot., datë 15.06.2020. Në këtë shkresë parashtrahet: “*Duke marrë shkas nga performanca jo në nivelin e duhur e znj. D. K, me detyrë Specialiste e kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Lis dhe nevojave emergjente që ka për mbulimin e shpejtë të këtij pozicioni pune për të ofruar një shërbim me cilësi dhe sa më afër banorëve të kësaj njësie administrative, kërkoj që të kryhen procedurat ligjore për transferimin e përkohshëm në interes të Bashkisë Mat në këtë pozicion pune të z. M. D., me detyrë Specialist i kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Rukaj, ndërkohë znj. D.K aktualisht me detyrë specialiste e kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Lis, të transferohet në të njëjtin pozicion pune në Njësinë Administrative Rukaj.*”

Me shkresën nr. 2327 prot., datë 16.6.2020, të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të transferimit. Ky njoftim nuk përmban asnjë të dhënë në lidhje me vendin e punës ku ankuesja do të transferohet, por vetëm arsyen e transferimit dhe se ankuesja duhet të kontaktonte brenda afateve ligjore me Njësinë e Burimeve Njerëzore. Me shkresën nr. 2327/1 prot., datë 02.07.2020, ankuesja ka kthyer përgjigje lidhur me njoftimin duke kërkuar që të njihet zyrtarisht me arsyet dhe vendin e transferimit.

Në datën 03.07.2020, është mbajtur procesverbal nga z. G. P., Drejtori i Burimeve Njerëzore, znj. E. B., Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe znj. M. B., Specialiste e Burimeve Njerëzore. Sipas këtij procesverbali, rezulton se kontakti me ankuesen është vendosur në mënyrë telefonike duke i komunikuar arsyen e transferimit për përmirësimin e rezultateve në punë dhe vendin e punës ku do të transferohej si specialiste e kadastrës së tokës bujqësore në Njësinë Administrative Rukaj. Në procesverbal pasqyrohet se ankuesja nuk është dakort me transferimin duke pretenduar se është duke u diskriminuar që prej muajit shkurt për shkak të bindjeve politike. Pavarësisht mosdakortësisë me transferimin, rezulton se ankuesja është transferuar specialiste e kadastrës bujqësore në Njësinë Administrative Rukaj për periudhën 13.07.2020 deri në 13.10.2020.

Transferimi i përkohshëm i nëpunësit civil rregullohet nga VKM Nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”. Në pikën 2/b, pikat 7, 9 e 10, të VKM së sipërcituar parashikohet: “2. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil: b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve;.....7. Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore të mobilitetit brenda institucionit dhe në bazë të planeve vjetore të mobilitetit të përgjithshëm për administratën shtetërore. Transferimi bëhet me kërkesë të tij dhe të eprorit direkt ose me kërkesë të secilit prej tyre dhe miratohet nga njësia përgjegjëse. Plani vjetor i mobilitetit, në kuptim të kësaj pike, është plani i transferimeve të përkohshme në rast të nevojës së institucionit ose përmirësimit të rezultateve në punë. 9. Nëpunësi civil ka të drejtë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të refuzojë me shkrim transferimin e përkohshëm pranë njësisë përgjegjëse dhe të dëgjohet prej saj, nëse: a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë së 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 10. Njësia përgjegjëse merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës dhe përveç rasteve të parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi, është i detyrueshëm.”

Sipas Planit të Mobilitetit të vitit 2020, numër “s”ka”, miratuar në datë 31.01.2020, nga Kryetari i Bashkisë Mat, ndër pozicionet që parashikohen të transferohen është ai i ankueses, specialiste e kadastrës së tokës bujqësore, Njësia Administrative Lis dhe destinacioni i parashikuar i transferimit është specialist i kadastrës së tokës bujqësore Njësia Administrative Rukaj ose Ulëz. Arsyerja e transferimit e përcaktuar në Planin e Mobilitetit është “përmirësimi i rezultateve të punës”. Referuar Planit të Mobilitetit si dhe vendimeve për transferimet e përkohshme të nëpunësve të tjerë të depozituar nga ana e bashkisë, rezulton se, ankuesja është e vetmja që është transferuar me motivacionin për të përmirësuar rezultatet në punë. Sipas këtij plani parashikohen edhe pesë pozicione të tjera që do ti nënshtrohen transferimit gjatë vitit 2020. Për të pesë këto raste, arsyeja e

transferimit është “*për nevoja të institucionit*”. Sa më sipër rezulton se asnjë nga pozicionet e tjera të parashikuara për transferim të përkohshëm nuk ndodhet në të njëjtat kushte me ankuesen.

Komisioneri konstaton se, formalisht aryesja e transferimit për të përmirësuar rezultatet në punës, përbën një arsye të ligjshme për transferimin e përkohshëm të një nëpunësi civil. Gjithashtu, nuk konstatohen situata në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga pika 9, të VKM-së nr. 125/2016, por as nuk pretendohen nga ankuesja dhe transferimi është bërë brenda të njëjtës kategori sipas përcaktimit të pikës 2, të VKM-së, së sipërcituar.

Bashkia Mat, deklaroi gjatë shqyrtimit të ankesës, se për transferimin e ankueses është bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 si dhe ecurinë e saj gjatë vitit 2020. Në kushtet kur konstatohet se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm gjatë vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, por edhe për atë të 6 mujorit të parë të vitit 2020, Komisioneri arrin në përfundimin se aryeja për të transferuar në mënyrë të përkohshme ankuesen për të përmirësuar rezultat në punë, është e pabazuar, pasi performanca e dobët në punë e ankueses e pretenduar nga ana e bashkisë mbetet e paprovuar. Konstatohet gjithashtu se kërkesa për transferimin e ankueses, nuk është bërë nga eprori direkt, sikurse parashikohet nga VKM nr. 125/2016, por nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në lidhje me distancën dhe transportin për në Njësinë Administrative Rukaj dhe Njësinë Administrative Lis, rezulton se, distanca e këtyre njësive administrative me qytetin e Burrelit ku ka vendbanimin ankuesja, raportohet e ndryshme në akte të ndryshme të Bashkisë Mat. Bazuar në aktet e administruara distanca e rrugës nga Burreli në Njësinë Administrative Lis, është 17 km, ndërsa distanca e rrugës nga Burreli në Njësinë Administrative Rukaj (qendra e Njësisë Bruç) raportohet 21.2 km sipas shkresës nr. 3263/1 prot., datë 28.07.2021 të Bashkisë Mat dhe 22.64 km sipas linjës së transportit të mësuesve.

Nuk rezultoi e provuar se ka transport publik për të siguruar lëvizjen nga qyteti i Burrelit për në Bruç, qendra e Njësisë Administrative Rukaj. Rrjeti i linjave të transportit të udhëtarëve në linjë të rregullt rrethqytetëse në Bashkinë Mat, miratuar me vendimin nr. 38, datë 24.07.2017 të Kryetarit të Bashkisë Mat, nuk provon se linja e parashikuar “Bruç-Burrel-Bruç” është linjë e cila funksionon efektivisht. Bashkia Mat nuk depozitoi prova që të provonte se operatorë të caktuar të transportit ishin ofrues të linjës së pretenduar. Gjithashtu, konstatohet se oraret e nisjes nga Bruç (qendra e Njësisë Administrative Rukaj) për në Burrel janë në oraret: 6.30, 6.45, 7.15 dhe 12.00 ndërsa oraret e kthimit nga qyteti i Burrelit për në Bruç janë: 12.30, 13.30, 14.30 dhe 16.15. Asnjë nga këto orare nuk mundëson transportin në orarin e kërkuar për kohëzgjatjen e punës së nëpunësve civil që është 8.00 deri në 16.30 nga dita e hënë deri ditën e enjte dhe 8.30 deri në 14.00 ditën e premte.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, transferimi i përkohshëm i ankueses në Njësinë Administrative Rukaj, për periudhën nga 13.07.2020 deri në 13.10.2020, e ka ekspozuar ankuesen ndaj që trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

A/4 Në lidhje me masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil.

Rreth 1 muaj pasi ankuesja ishte rikthyer në vendin e saj të punës, pas transferimit të përkohshëm, rezulton se me shkresën nr. 5349 prot., datë 07.12.2020, të Komisionit të Disiplinës së Bashkisë Mat, ndaj ankueses ka filluar procedimi disiplinor për shkak se kjo punonjëse nuk ka zbatuar dy urdhra të Kryetarit të Bashkisë. Konkretisht, urdhrin nr. 119, datë 17.2.2020 *“Për ngritjen e komisionit për verifikimin në terren të ankesës së paraqitur nga z. F. B. ndaj z. G. B.”* dhe urdhrin nr. 120, datë 12.02.2020 *“Për ngritjen e komisionit për verifikimin në terren të ankesës së paraqitur nga z. Xh. Q. ndaj z. A. Q.”*. Kjo procedurë ka filluar me kërkesë të Administratorit të Njësisë Administrative Lis, z. K.M, i cili me shkresën nr. 613 prot., datë 26.11.2020, duke e klasifikuar si shkelje shumë të rëndë të disiplinës, e ka përcjellë për shqyrtim pranë Komisionit të Disiplinës të Bashkisë Mat.

Referuar dy urdhrave të sipërcituar të Kryetarit të Bashkisë, ankuesja ka qenë pjesë e dy komisioneve të ngritura sipas këtyre urdhrave së bashku me gjashtë anëtarë të tjerë. Bazuar në raportin mjekësor me nr. 656 regjistri, lëshuar në datën 15.02.2020 nga Qendra Shëndetësore Burrel, ankuesja ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë nga data 12.02.2020 deri në datën 14.02.2020, e aftë për punë në datën 15.02.2020. Referuar listëprezencës me nr. 85 prot., datë 28.02.2020, të Njësisë Administrative Lis, ankuesja është pasqyruar me raport mjekësor.

Bazuar në raportin mjekësor me nr. regjistri 656, lëshuar në datë 15.02.2020, nga Qendra Shëndetësore Burrel, ankuesja ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë nga data 15.02.2020 (ditë e shtunë) deri në datën 21.02.2020, e aftë për punë në datën 22.02.2020 (ditë e shtunë). Urdhrat e mësipërm të Kryetarit të Bashkisë janë nxjerrë në datë 17.02.2020, kur ankuesja ka qenë me raport mjekësor që vërteton paaftësinë e saj për punë.

Fillimisht me shkresën nr. 74 prot., datë 21.02.2020, Administratori i Njësisë Administrative Lis ka propozuar dhënien e masës disiplinore ndaj ankueses për mosparaqitje në punë dhe moszbatimin e urdhrave të Kryetarit të Bashkisë. Ndër të tjera në këtë shkresë drejtuar Kryetarit të Bashkisë, Administratori i Njësisë Administrative Lis z. K.M shprehet se: *“ Ju bëj me dije se raporta mjekësore e paraqitur nga punonjësja e kadastrës znj. D.K më është vënë në dispozicion nga punonjësi E. M, ditën e martë të datës 18.2.2020. Pra që nga data 12, 13, 14, punonjësja nuk më ka dorëzuar raportën brenda afatit ligjor, por e ka dorëzuar me datën 18.02.2020. Dhe nga data 17, 18, 19, 20, 21.02.2020 nuk është paraqitur në punë duke thyer kështu edhe urdhrin e punës me nr. 110 të dalë nga Kryetari i Bashkisë z. Agron Malaj me nr.prot 109, dt. 12.02.2020 për Adresarin. Po ashtu ka thyer dhe dy urdhëra të tjerë me nr. 119, dt. 17.02.2020 me nr.prot 675 dhe tjetri me nr.120, dt. 17.02.2020, prot 676....”* Lidhur me këtë propozim të Administratorit të

Njësisë, me shkresën nr. 831 prot., datë 24.02.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Mat, rezulton se ankuesja është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore, por pa cituar shkeljet e pretenduara dhe me referencë në dispozitat e Kodit të Punës. Në përgjigje të këtij njoftimi ankuesja me shkresën e datës 28.02.2020 e ka kundërshtuar fillimin e ecurisë disiplinore. Sipas procesverbalit datë 02.03.2020, të mbajtur në praninë e ankueses, Sekretarit të Përgjithshëm z. E. H., Drejtorit të Burimeve Njerëzore, znj. E .B. Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe znj. M. B., specialiste e burimeve njerëzore, është realizuar një takim në lidhje me propozimin e masës disiplinore gjatë të cilit ankuesja ka pretenduar se është duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike. Pas këtij takimi, nuk rezulton që ky procedim disiplinor të ketë vijuar më tej.

Pas disa muajsh, me shkresën nr. 613 prot., datë 26.11.2020, Administratori i Njësisë Administrative Lis, ka përcjellë përsëri propozimin për marrjen e masës disiplinore ndaj ankueses lidhur me moszbatimin e dy urdharve të sipërcituar të Kryetarit të Bashkisë. Moszbatimi i dy Urdhrave të Kryetarit të Bashkisë është klasifikuar nga Administratori, z. M, si shkelje shumë e rëndë dhe për këtë arsye e ka përcjellë propozimin për marrjen e masës disiplinore pranë Komisionit të Disiplinës të Bashkisë Mat.

Në Kreun IV, nenet 57- 61, të ligjit nr.152/2013 “*Për Nëpunësin civil*”, të ndryshuar, rregullohet disiplina në shërbimin civil. Sipas ligjit, nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit. Në nenin 57, pika 1 dhe 57, pika 2, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: “.....1..*Shkeljet në shërbimin civil ndahen në: a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta. 2. Janë shkelje shumë të rënda: a) mospërmbushja e rëndë e detyrave;*”

Sipas nenit 58, të ligjit të mësipërm, parashikohet : “*Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë: a) vërejtje; b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet. ç) largim nga shërbimi civil.*”

Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore, parashikohet në nenin 59, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të, ku parashikohet: “*1. Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil. 2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor*”

Bazuar në pikën 4/a, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, parashikohet se, Komisioni disiplinor fillon procedimin, ndër të tjera me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil.

Sipas njoftimit për fillimin e ecurisë disiplinore nr. 5349 prot., datë 07.12.2020, të Komisionit Disiplinor, ecuria disiplinore ndaj ankueses për shkeljet e konstatuara nga eprori direkt, Administratori z. K.M, është klasifikuar si shkelje shumë e rëndë, sipas nenit 57, pika 2/a të ligjit nr. 152/2013.

Sipas pikës 7, të nenit 57, të ligjit nr.152/2013, parashikohet se: *“7. Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate”*.

Rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore përcaktohen në VKM-në Nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Nga tërëria e akteve dhe informacionit të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezulton se gjatë procedimit disiplinor ankueses i janë garantuar të drejtat e mësimperme, për të marrë dijeni për shkeljen e pretenduar, për t’u njohur me aktet dhe për t’u dëgjuar.

Duke ju rikthyer shkeljeve të konstatuara, konstatohet se me dy urdhrat e Kryetarit të Bashkisë, ankuesja është caktuar si anëtare në dy komisionet e ngritura për kryerjen e verifikimeve në terren të ankesave të paraqitura nga qytetarët, që kishin të bënin me çështje pronash. Bashkia Mat dhe Administratori i Njësisë Administrative Lis, pretendojnë se nuk kanë patur dijeni për gjendjen shëndetësore të ankueses, pasi ajo nuk ka dorëzuar brenda afateve ligjore raportin mjekësor.

Bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Mat, në nenin 8, të saj *“Disiplina formale”* përcaktohet : *“8.5 Çdo mungesë në detyrë bëhet me leje, veç rasteve shëndetësore, për të cilat të bëhet njoftimi telefonik në drejtorinë përkatëse, e cila njofton Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, duke dorëzuar raport mjekësor ditën e parë të paraqitjes në punë. 8.6 Listëprezenca për çdo punonjës të Bashkisë, përgatitet nga Drejtuesi i njësisë organizative, dhe depozitohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Afati për dorëzimin e listëprezencës pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, është data e fundit e çdo muaji.”*

Sipas rregullit të mësipërm raporti mjekësor paraqitet nga nëpunësi ditën e parë të paraqitjes në punë dhe jo ditën e lëshimit të raportit mjekësor nga mjeku. Nga data 12.02.2020, dita e parë kur ankuesja ka qenë me raportin e parë mjekësor, është rikthyer në punë në datën 24.02.2020, pas raportit të dytë mjekësor për datat 15.02.2020 deri në datë 21.02.2020, e aftë për punë në datë 22.02.2020, ditë e shtunë. Ankuesja është paraqitur në punë në datën 24.02.2020, ditë kur ajo ka patur të drejtën të depozitonte raportin mjekësor, sipas rregullimit të vendosur në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Mat.

Ankueses nuk i është njohur raporti mjekësor për datat 17-21 shkurt 2020 dhe ajo është pasqyruar me mungesë në punë në listëprezencën e punonjësve për këtë periudhë. Dy urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Mat kanë dalë në datën 17.02.2020, kur ankuesja nuk ka qenë prezent në punë. Ndaj ankueses nuk është marrë asnjë procedim në lidhje me mosrespektimin e disiplinës formale në lidhje me njoftimin e eprorit të drejtpërdrejtë për raportin mjekësor, por ankuesja është proceduar disiplinarisht për moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë të dalë në një kohë që ajo nuk ka qenë në punë.

Urdhrat e Bashkisë për verifikimet e ankesave të qytetarëve si më sipërcituar, nuk kanë parashikuar asnjë modalitet apo afat kohor për veprimtarinë e Komisioneve të Verifikimit. Në vendimin e Komisionit të Disiplinës për dhënien e masës disiplinore arsyetohet se ankuesja u bë pengesa kryesore e moszbatimit të urdhrave dhe e gjitha kjo, ka krijuar një gjendje të rënduar të marrëdhënieve të fqinjësisë ndërmjet palëve në konflikt, pasi konflikti nuk është zgjidhur. Komisioni i Disiplinës arsyeton se, e gjithë kjo situatë është rezultat i mospërmbushjes së rëndë të detyrave nga ankuesja dhe ka sjellë si pasojë vijimin e konfliktit dhe cënimin e dukshëm të sigurisë publike në komunitet.

Në nenin 60, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, parashikohet zbatimi i parimit të përshkallëzimit dhe individualizimi i masës disiplinore ndaj nëpunësit civil. Në këtë nen parashikohet si vijon: “1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, eprori direkt ose komisioni disiplinor bazohet në: a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj; b) shkallën e fajësisë; c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë më shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në pikën 2 të nenit 57 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e rënda të parashikuara në pikën 3 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “b” ose “c” të nenit 58 të këtij ligji. 5. Për shkeljet e lehta të parashikuara në pikën 4 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji. 6. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.”

Bazuar në nenin 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.
- I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe
- Në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në

shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e detytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimit dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”

Nga aktet e administruara rezulton se, për zbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë janë mbajtur dy procesverbale datë 20.02.2020 nga ana e Komisioneve të Verifikimit. Gjithashtu me anë të dy procesverbaleve me nr.extra prot., datë 20.02.2020, Administratori i Njesisë Administrative Lis, ka mbajtur dy procesverbale, ku relatohet se znj. D.K nuk ka marrë pjesë në veprimet e Komisioneve të Verifikimit të mbajtur në datën 20.02.2020, datë kur ankuesja rezulton se nuk ka qenë në punë pasi ka qenë me raport mjekësor. Nuk rezulton e provuar, se nga ana e Komisioneve të Verifikimit të jenë kryer veprime të mëtëjshme verifikuese, në zbatim të urdhrave të Kryetarit të Bashkisë, ku ankuesja nuk ka marrë pjesë pas kthimit në punë. Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nuk përcaktojnë asnjë modalitet dhe ndarje të përgjegjësisive në lidhje me veprimet që duhet të kryhen nga grupet e punës. Gjithashtu, nga aktet e administruara nuk rezulton e parashikuar që ankuesja, si Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njesisë Administrative Lis ka si detyrë funksionale zgjidhjen e konflikteve të pronësisë. Nuk rezultoi e provuar se si ankuesja në cilësinë e anëtares në Komisionet Verifikuese të ngritura me dy Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë, me sjelljen e saj është bërë pengesë për moszbatimin e urdhrave, pasi ajo nuk ka qenë e vetmja e ngarkuar për zgjidhjen e problematikave. Në vijim, rezulton se, gjatë muajve mars dhe prill 2020 veprimtaria institucionale ka qenë e kufizuar dhe e kushtëzuar nga situata e shkaktuar nga Covid 19, më pas për tre muaj ankuesja gjatë vitit 2020 ka qenë e transferuar në Njesisë Administrative Rukaj. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies në shërbimin civil, ndaj ankueses nuk rezultoi e provuar që të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore.

Sa më sipër, rezulton se, Bashkia Mat nuk ka bërë një kualifikim të saktë të faktit dhe përcaktimit si shkelje disiplinore të sjelljes së ankueses si nëpunëse civile dhe llojit të masës disiplinore të dhënë ndaj saj. Rezultoi e provuar se faktet e pretenduara nuk përbëjnë mospërbushje të rëndë të detyrave, për t'u klasifikuar si shkelje shumë e rëndë, sipas nenit 57/2/a, të ligjit nr.152/2013. Për rrjedhojë marrja e masës më të rëndë disiplinore të parashikuar nga ligji, për largim nga shërbimi civil të ankueses, duke e cilësuar moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Mat si mospërbushje e rëndë e detyrave, është në çënim të parimit të proporcionalitetit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në pëfundimin se, ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me dhënien e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil.

A/5 Në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të pretendimeve për diskriminim për shkak të bindjeve politike të paraqitura përpara punëdhënësit.

Bazuar në nenin 13/c, të LMD-së, punëdhënësi është i detyruar t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre.

Nga aktet e administruara, rezulton se, në mënyrë të përsëritur ankuesja ka paraqitur përpara Bashkisë Mat në cilësinë e punëdhënësit, pretendimin e saj se është duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike. Një fakt i tillë rezulton i provuar nga shkresa e datës 24.02.2020 dhe 28.02.2020 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me vlerësimin e punës, gjatë takimit të realizuar me Sekretarin e Përgjithshëm në datën 02.03.2020 në lidhje me propozimin e Administratorit për masë disiplinore ndaj ankuses në muajin shkurt 2020, shkresën drejtuar Kryetarit të Bashkisë datë 05.05.2020, në të cilën ankuesja parashtron problematikat në lidhje me vlerësimin e punës, pagesën e raporteve mjekësore si dhe kushtet në të cilat i është dashur që të punojë gjatë muajve mars-prill 2020 dhe faktin se nuk ka marrë një zgjidhje, si dhe gjatë takimit të zhvilluar në distancë në datën 03.07.2020, lidhur me procedurën e transferimit.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se, Bashkia Mat në cilësinë e punëdhënësit nuk ka ndërmarrë asnjë masë për shqyrtimin e pretendimeve për diskriminim politik të paraqitura nga ankuesja. Në këtë mënyrë, Bashkia Mat ka shkelur nenin 13/c të LMD, duke dështuar që t'i përgjigjet efektivisht ankesave për diskriminim të paraqitura nga ankuesja.

Sa më sipër, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat, pasi i është cënuar e drejta për të patur një zgjidhje efektive për pretendimet për diskriminim politik të paraqitura përpara punëdhënësit.

B. Shkaku i mbrojtur

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin nr.31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të rganizatave ose partive politike.”*

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për, ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Ankuesja shpjegon se, është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe se bindjet e saj, politike janë të kundërta me ato të punëdhënësit të saj, Kryetarit të Bashkisë Mat.

Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesja ka depozituar vërtetimin nr.67, prot., datë 24.03.2020, të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mat, me anë të të cilit vërtetohet se, znj. D.K që nga viti 2005 e deri në janar të vitit 2017 ka qenë anëtare e Kryesisë së Partisë Demokratike Dega Mat dhe njëkohësisht Nënkyetare e Forumit të Gruas. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja e mbart shkaku e pretenduar të diskriminimit atë të bindjeve politike.

Rezulton gjithashtu se, z. Agron Malaj, është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Mat në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste⁷. Bazuar në të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, për zbatimin e ligjit nr.138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Agron Malaj, raporton se për periudhën maj 2015 – nëntor 2016 ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Partisë Socialiste, Dega Mat dhe për periudhën nëntor 2016 e në vazhdim ka qenë Koordinator Elektorale i Partisë Socialiste, për Bashkinë Mat dhe Klos.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar edhe nga Administratori i Njësisë Administrative Lis z. K.M, duke pretenduar se edhe ky i fundit ka të njëjtat bindje sikundër Kryetari i Bashkisë Mat. Nga verifikimet e kryera nga ana e Komisionerit rezultoi se, z. K.M, ka qenë delegat për Kongresin e Partisë Socialiste, për Bashkinë Mat, bazuar në zgjedhjet e 16 nëntorit 2019, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Partisë Socialiste⁸.

⁷ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al,

⁸ <https://ps.al/te-reja/lista-e-delegatave-te-kongresit-te-partise-socialiste-qe-fituan-ne-zgjedhjet-e-16-nentorit>.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet, ashtu edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës, sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja) nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimtimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: (a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; (b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; (c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; (d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁹, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹⁰. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*¹¹ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e

⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁰ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

¹¹ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të opinionit politik.

*Karta Sociale Evropiane*¹² në nenin 1, pika 2, parashikon: “ *Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...* ” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹³. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Në bazë të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁴ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*”

¹² Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹³ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

¹⁴ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Sa më sipër, ankuesja duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁵

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës “*praesumptio iuris tantum*”.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtuara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁶”.

Bashkia Mat pretendoi se ankuesja nuk i provonte bindjet e saj politike nëpërmjet vërtetimit të PD Dega Mat, pasi nuk kishte depozituar ndonjë kartë anëtarësie apo kërkesën e dorëheqjes. Megjithatë në arsyetimin vijues të qëndrimit të mbajtur nga ana e saj, Bashkia Mat shprehet se posedimi i një dokumenti që provon anëtarësinë në një parti ose vërtetim i çfarëdolloji i lëshuar nga subjekti politik, nuk provojnë pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike, për sa kohë që sipas Bashkisë Mat, në strukturat e saj vazhdojnë të punojnë punonjës, të cilët i përkasin

¹⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁶ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

të njëjtës forcë politike sikundër ankuesja. Madje Bashkia Mat konfirmon se ka dijani në lidhje me pozicionet drejtuese që këta punonjës kanë mbajtur ose mbajnë në subjektin politik të cilës i përket edhe ankuesja. Në këtë mënyrë, Bashkia Mat pranon faktin se ajo ka dijani për bindjet politike të punonjësve të saj, për rrjedhojë, mundësia më e madhe është që bashkia ka patur dijani për bindjet politike të ankueses. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, provat e administruara, janë të mjaftueshme në mbështetje të faktit se, punëdhënësi ka patur dijani për bindjet politike të ankueses.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë marrëdhënieve të punës, duke përfshirë vlerësimin e rezultave në punë për 6 mujorin e dytë të 2019, kushtet e punës në kulmin e pandemisë Covid 19, gjatë muajve mars dhe prill dhe transferimin e përkohshëm 3 mujor në Njësinë Administrative Rukaj, deri në përfundimin e marrëdhënieve të punës dhe marrjen e masës disiplinore për largimin nga shërbimi civil. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankueses dhe fakti se Bashkia Mat, ka patur dijani për bindjet politike të ankueses.

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimit, të cilat u provuan gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se:

- Administratori i Njësisë Administrative Lis, z. K.M, i cili është emëruar në detyrë në datë 21.10.2019 ka kryer vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, në datën 11.01.2020. Nuk rezultoi e provuar që të jenë bërë përpjekje për të marrë vlerësimin nga ana e ish Administratorit të mëparshëm, z. U.K i cili është larguar nga puna në të njëjtën datë dhe ka qenë zyrtari në detyrë për periudhën korrik-21.10.2019. Gjithashtu, megjithëse ka qenë në dijani për Raport Auditimin (Përfundimtar) të datës 18.12.2020, i mbajtur nga strukturat audituese të bashkisë Mat, Administratori nuk ka mbajtur në konsideratë konstatimet e bëra në këtë raport lidhur me ushtrimin e detyrës nga ana e ankueses për periudhën gjatë të cilës ai nuk ka qenë në detyrë. Administratori i Njësisë Administrative Lis, ka vlerësuar rezultate në punë të ankueses me vlerësimin më të ulët “jo kënaqshëm” për 6 mujorin e dytë të 2019 duke qenë në pozicionin e zyrtarit raportues vetëm në dy muajt e fundit të 2019.
- Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat, në cilësinë e zyrtarit konfirmues/autorizues, ka kryer rishikimin e vlerësimit në punë të ankueses pa i dhënë asaj mundësinë që të dëgjohet në lidhje me pretendimet e saj. Bashkia Mat nuk provoi pretendimet se ankuesja nuk kishte pranuar të bashkëpunonte, për sa kohë nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me faktin se si ishte njoftuar ajo në lidhje me këtë proces. Rezultoi e provuar se, ankuesja nuk ka marrë dijani në lidhje me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.
- Vlerësimi i rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të 2020, është bërë në kundërshtim të plotë me parashikimet ligjore në fuqi dhe ankuesja në asnjë fazë të procesit nuk është bërë me dijani. Pretendimet se ankuesja nuk ka bashkëpunuar nuk rezultuan të provuara. I takon Administratorit të Njësisë Administrative Lis dhe Bashkisë Mat, të provojnë se kanë respektuar procedurën e vlerësimit dhe kanë njoftuar ankuesen. Ankueses i është mohuar e drejta për të kundërshtuar vlerësimin e punës, pasi ajo nuk ka patur dijani.

- Ndërsa u provua se, gjatë muajve mars –prill 2020, periudhë e cila ka shënuar kulmin e masave kufizuese në kushtet e situatës së krijuar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ankueses duhet t’i ishin mundësuar forma alternative për të përmbushur funksionet e saj, sikurse është puna në distancë ose alternimi i saj me prezencën fizike, Bashkia Mat, nuk dha asnjë shpjegim se përse natyra e punës së ankueses mbarte specifika, të cilat nuk lejonin kryerjen e saj nëpërmjet punës në distancë ose për të krijuar mundësinë e kryerjes së detyrave duke alternuar prezencën fizike dhe punën në distancë, në kushtet kur gjatë kësaj periudhe kërkoheshmangia e kontaktit fizik dhe ofrimi i shërbimeve nëpërmjet prezencës fizike vetëm për arsye të domosdoshme. Gjithashtu, transporti gjatë këtyre muajve ka qenë i ndaluar dhe lejohej vetëm në kushte shumë specifike.
- Bashkia Mat pretendoi, por nuk arriti të provojë asnjë nga rastet e punonjësve që sipas saj ndodhen në kushte të ngjashme me ankuesen dhe janë paraqitur çdo ditë në punë gjatë periudhës mars-prill 2020, në kushtet e emergjencës së shkaktuar nuk rezultoi i provuar, duke mbetur në nivel deklarativ nga ana e Bashkisë Mat.
- Arsyja e transferimit për të përmirësuar rezultatet në punës, përbën një arsye të ligjshme për transferimin e përkohshëm të një nëpunësi civil. Arsyja e transferimit nuk duhet të jetë e ligjshme vetëm formalisht, por duhet të provohet. Performanca e dobët në punë e ankueses e pretenduar nga ana e bashkisë, nuk rezultoi e provuar, pasi vlerësimet që i janë bërë ankueses nuk mund të shërbejnë si një tregues objektiv i performancës jo të mirë në punë të ankueses, pasi nuk janë kryer sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Për rrjedhojë transferimi i përkohshëm i ankueses në Njësinë Administrative Rukaj është i pabazuar.
- Transferimi i ankueses në Njësinë Administrative Rukaj përkeqësoi kushtet e punës së ankueses, pasi kjo njësi ndodhet në një distancë më të largët se Njësia Administrative Lis dhe nuk rezultoi e provuar që ka transport.
- Transferimi i ankueses është bërë për arsye të përmirësimit të performancës në punë, që do të thotë se përzgjedhja e vendit të punës ku ankuesi do të transferohet për të përmirësuar rezultatet e tij në punë duhet të jetë i tillë që të garantojë këtë qëllim të synuar nëpërmjet transferimit. Referuar propozimit që Sekretari i Përgjithshëm ka bërë për Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, ai shprehet se ankuesja ka një performancë jo të kënaqshme dhe ka nevojë emergjente që banorët e Njësisë Administrative Lis të marrin shërbime cilësore. Ankuesja është transferuar nga një njësi administrative në një tjetër njësi administrative të Bashkisë Mat, dhe kjo e fundit nuk ofroi asnjë shpjegim se përse vendi i punës ku ankuesja u transferua do të garantonte përmirësimin e saj në punë për sa kohë që arsyja e transferimit është përmirësimi i rezultateve në punë të ankueses. Nevoja për ofrimin e shërbimeve cilësore për banorët e Njësisë Administrative Lis, jo vetëm që bie në kundërshtim me arsyen e transferimit, por edhe me faktin se Bashkia Mat nuk shqetësohet në lidhje me cilësinë e shërbimeve që do të marrin banorët e Njësisë Administrative Rukaj ku transferohet ankuesja. Komisioneri vlerëson se arsyetimet e Bashkisë Mat janë kontradiktore.
- Referuar Planit të Mobilitetit të vitit 2020, të depozituar nga Bashkia Mat, asnjë nga nëpunësit e tjerë të transferuar nuk ndodhet në të njëjtat kushte me ankuesen, pasi ajo është e vetmja që

është transferuar për përmirësimin e rezultateve në punë, ndërsa nëpunësit e tjerë civilë janë transferuar për nevoja të institucionit.

- Në lidhje me nëpunësen civile V.M, të transferuar sikurse ankuesja, me vendimin nr.25 datë 24.01.2022, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e saj për shkak të bindjeve politike nga ana e Bashkisë Mat, ndërsa nëpunësja tjetër civile V.T, si pasojë e transferimit është transferuar në pozicion e mbajtur nga nëpunësja V.M. Nga aktet e administruara në lidhje me transferimet e nëpunësve civilë, Komisioneri konstaton se, Bashkia Mat ka transferuar punonjësit për nevoja të institucionit, në pozicione pune të cilat kanë qenë të mbuluar me personel ekzistues, duke i transferuar punonjësit nga një njësi administrative në një tjetër njësi administrative të Bashkisë Mat ose nga njësi administrative në administratën qendrore të bashkisë në qytetin e Burrelit, si në rastin e nëpunëses civile V.T dhe duke marrë në punë punonjës të rinj në vakancat e krijuara si pasojë e nëpunësve civilë të transferuar. Konkretisht: Me Vendimin nr.579, datë 31.08.2020 *“Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”*, V.M është transferuar për nevoja të institucionit në pozicionin Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan; Me Vendimin nr.676, datë 14.10.2020 *“Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”*, V.T nga nëpunëse civile në pozicionin Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms, transferohet në të njëjtin pozicion në Njësinë Administrative Burrel (në pozicionin që kishte V.M); Me Urdhërin nr. 679, datë 16.10.2020 *“Për emërim punonjësi”*, A.L është emëruar në pozicionin Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms (në pozicionin që kishte V.T); A.L është punonjëse e re dhe marrja e saj në punë nuk i është nënshtruar konkurimit të hapur, sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Procedurat e transferimit të përkohshëm të punonjësve të ndjekura nga ana e Bashkisë Mat, ngrenë dyshime në lidhje me nevojën reale të institucionit për këto lëvizje të punonjësve.
- Faktet e pretenduara për moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Mat, nuk përbëjnë mospërbushje të rëndë të detyrave dhe haptazi në mënyrë të pabazuar, është kualifikuar si shkelje shumë e rëndë, sipas nenit 57/2/a, të ligjit nr.152/2013. Kualifikimi i fakteve të pretenduara si shkelje shumë e rëndë, ka si të vetmen pasojë masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil, ndryshe nga kualifikimet e tjera të shkeljeve të cilat parashikohet dhënia e masave më të lehta disiplinore. Marrja e masës më të rëndë disiplinore të parashikuar nga ligji, për largim nga shërbimi civil të ankueses, duke e cilësuar moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Mat si mospërbushje e rëndë e detyrave, është në çenim të parimit të proporcionalitetit.
- Të gjitha konstatimet e mësipërme kanë ndodhur pas marrjes së detyrës nga Kryetari i ri i Bashkisë Mat, i zgjedhur në zgjedhjet vendore të qershorit 2019 dhe emërimit të Administratorit të Njësisë Administrative Lis z. K.M, në fund të muajit tetor 2019, emëruar pas largimit nga puna të administratorit të mëparshëm. Nuk rezultoi e provuar që përpara këtij momenti, ankuesja të ketë patur problematika në punë.
- Pavarësisht ankesave të përsëritura të ankueses, se është duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike, Bashkia Mat në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 13, i LMD-së nuk mori asnjë masë për të trajtuar ankesat për diskriminim.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, për shkak të bindjeve të tij politike.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së, në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi bazën e të cilave mund të prezumohet se ka patur diskriminim, atëherë i takon palës tjetër kundër të cilës është paraqitur ankesa që të provojë të kundërtën, se faktet nuk përbëjnë diskriminim. Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i saj është kryer për shkak të bindjeve politike. Në këto kushte, subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, kishin barrën e provës që të provonin ligjshmërinë e veprimeve të tyre, në mënyrë që hidhnin poshtë pretendimet e ankuseses se këto veprime janë kryer për shkak të bindjeve politike. Në mungesë të një justifikimi të përligjur në lidhje me sjelljen e Administratorit të Njesisë Administrative Lis dhe Bashkisë Mat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj ankuseses, mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja, pra bindjet politike.

Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi i tretë i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore, pasi në mungesë të një justifikimi për ligjshmërinë e veprimeve nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Lis dhe Bashkisë Mat, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj të cilit është ekspozuar ankuesja, shkaku i mbrojtur, pra bindjet politike, mbeten i vetmi shpjegim i arsyeshëm.

Në konkluzion sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Mat ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1, nenin 12, pika 1, gërma "c" dhe nenin 13, pika 1, germa "c" duke e diskriminuar ankuesen D.K, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike.

Bashkia Mat pretendoi se, Njësia Administrative Lis, nuk mund jetë subjekt në këtë procedurë, pasi ajo është pjesë e strukturës së Bashkisë Mat dhe Njësia Administrative Lis nuk ka të drejtë të veprojë si subjekt i së drejtës më vete në marrëdhënie me të tretët, pasi nuk i është deleguar asnjë funksion i tillë, që ta konsideronte atë si entitet i shkëputur nga Bashkia Mat.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, rezulton se, me veprimet dhe mosveprimet e tij, Administratori i Njesisë Administrative Lis, në cilësinë e drejtuesit të kësaj njësie, ka ndihmuar në qëllimin për të diskriminuar. Sa më sipër dhe bazuar në nenin 3, pika 12, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ku parashikohet : "*10. Nxitja ose ndihma për diskriminim është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një ose më shumë persona nxisin ose ndihmojnë një ose më shumë persona të tjerë, duke përfshirë edhe financimin e tyre, me qëllim për të diskriminuar, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.*",

Komisioneri arrin në përfundimin e Administratori i Njësisë Administrative Lis, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka ndihmuar për diskriminimin e ankueses, për shkak të bindjeve politike dhe për rrjedhojë ai gjendet përgjegjës për diskriminimin e ankueses, pavarësisht se përgjegjësia finale rëndon mbi Bashkinë Mat, në cilësinë e punëdhënësit të ankueses.

Ankuesja D.K ka kërkuar që Komisioneri të marrë masa për rikthimin e saj në pozicionin e mëparshëm të punës, dëmshpërblim për dëmin e pësuar si pasojë e diskriminimit.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e rikthyer ankuesen në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Komisioneri vlerëon se, kërkimi i ankueses për dëmshpërblim për dëmin e pësuar si pasojë e diskriminimit, nuk hyn në kompetencat e Komisionerit. Bazuar në parashikimet e neneve 34-38, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesja ka të drejtën që t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar kompesimin për dëmin e pësuar si pasojë e diskriminimit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses D.K, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njësisë Administrative Lis.

2. Në referim të pikës 1, Bashkia Mat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer ankuesen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Në referim të pikës 1, Bashkia Mat dhe Administratori i Njësisë Administrative Lis, duhet të ndalojnë çdo veprim diskriminues ndaj ankueses në të ardhmen.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, subjektet e mësipërme, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha : Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim